

STEREOTIPET, PARAGJYKIMET, DISKRIMINIMI DHE GJUHA E URREJTJES



Projekte Vullnetare Nalërkombëtare



**NO HATE
SPEECH
MOVEMENT**



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Ky manual është përgatitur në kuadër të projektit “Lufta kundër Stereotipeve: Urrejtja shpërndahet nëse nuk flet me mbështetjen financiare të Fondacionit Rinor Evropian



Implementuar nga organizata Projekte Vullnetare Ndërkombëtare



Projekte Vullnetare Ndërkombëtare

Përgatitën manualin:

Oltiana Rama

Maire Rowland

Luis Bekteshi

Genc Muca

Shane Owens

Përkthyer nga Dafina Medulaj

Tiranë, Shqipëri, Mars 2017

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1: VËSHTRIM TEORIK

Hyrja	5
Përkufizimet	6
Stereotipet: Cilët janë efektet?	8
Identifikimi i steriotipeve	12
Korniza ligjore	14

KAPITULLI 2: TË DHËNAT NGA STUDIMI NË TERREN

Stereotipet: në Shqipëri	17
Perceptimet e të rinjve	18
Historit Personale	29

KAPITULLI 3: MËNYRAT E REDUKTIMIT

Lidhjet njerzore	35
Roli i institucioneve kompetente	38
Raportimi i gjuhës së urrejtjes	41

KAPITULLI 4: AKTIVITET

Aktivitete	43
------------	----

KAPITULLI 5: REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE

KAPITULLI 1: VËSHTRIM TEORIK

TË DASHUR LEXUES!

Njerëzit i duan kategoritë. Në mënyrë që të kuptojmë kompleksitetin e botës përreth nesh, ne krijojmë kategori dhe koncepte për gjithçka që përjetojmë apo ndeshim në jetë. Kjo është një pjesë e rëndësishme e mendimit njerëzor që na lejon ta përpunojmë informacionin në mënyrë sa më ekifase. Pa kategorizime e gjithë jeta jonë do të ishte një përshtjellim i rrëmujshëm.

Shpesh herë ne etiketojmë kur i referohemi grupeve të ndryshme të njerëzve. Ky etiketim mund të jetë një emër specifik i bazuar në nacionalitet, etni, fe, etj. Është një element natyror i psikologjisë tonë por përbën një problem nëse bazojmë gjithë sistemin tonë të besimit mbi të apo e lëmë sjellen tonë të diktohet nga etiketim i vendosur.

Ky manual u krijua për të eksploruar dhe zhvilluar kërkime mbi temën e stereotipeve në Shqipëri. Ai ka për qëllim të sfidojë stereotipet negative që mbizotërojnë në shoqërinë tonë duke ju prezantuar me teori dhe kërkime mbi këtë temë në nivel lokal. Stereotipet negative shpesh mund të çojnë në paragjykimë dhe diskriminime të minoriteteve. E krijuam këtë libërth si një mjet për të rinjtë për të luftuar urrejtjen, rracizmin, ksenofobinë, homofobinë, seksizmin etj. Informacioni i mbledhur dhe i prezantuar në këtë publikim u krijua nga të rinjtë për të rinjtë dhe ka për qëllim të trajtojë këtë temë të rëndësishme në një mënyrë të kuptueshme dhe të dobishme.

Ky manual u krijua gjatë një trajnimi kombëtarë të titulluar “Lufta kundër Stereotipeve: Urrejtja shpërndahet nëse nuk flet” me mbështetjen financiare të Fondacionit Rinor Evropian. Në trajnim morën pjesë 25 të rinj, të moshës 18- 30 vjeç, nga e gjithë Shqipëria gjatë periudhës 13- 20 Janar 2017. PVN së bashku me këta të rinjë frymëzues bënë kërkime, diskutuan dhe finalizuan të gjitha gjetjet e paraqitura në këtë manual.

Në këtë publikim përfshihen të dhëna të mbledhura nëpërmjet një pyetësori mbi këtë temë të zhvilluar në të gjithë Shqipërinë. Ne besojmë që ky informacion do të jetë i vlefshëm për të rinjtë. Ai do t’i sigurojë atyre një pamje më të qartë të realitetit për sa i përket stereotipeve dhe paragjykimeve në shoqërinë tonë. Le të shpresojmë që ky libërth do të çojë drejt ideve të reja dhe veprimeve konkrete, të cilat do të trajtojnë problemet me të cilët përballemi.

Qëllimi ynë ishte të shruanim dhe të publikonim një libërth për t’i pajisur edukatorët dhe të rinjtë në Shqipëri me informacion bazik mbi stereotipet paragjykimin dhe diskriminimin, për t’i dhënë një pamje mbi stereotipet gjithashtu duke ofruar resurse dhe ide për krijimin dhe zbatimin e trajnimeve mbi edukimin joformal.

Shpresojmë që ky kërkim dhe ky informacion t’ju vijë në ndihmë.



PËRKUFIZIMET

STEREOTIPE:

Stereotipet janë ide të thjeshtëzuara mbi grupe të caktuar njerëzish. Stereotipet mund të bazohen tek rraca, etniciteti, mosha, gjinia, orientimi seksual, pothuajse mbi çdo karakteristike. Ato mund të jenë pozitive (zakonisht karshi grupit ku bën vetë pjesë, p.sh. kur gratë pretendojnë se ato ankohen më pak ndaj dhunës fizike) por shpesh janë negjative (zakonisht karshi grupeve të tjera, si p.sh kur anëtarët e një grupi racial mbizotërues pretendojnë se një grup tjetër racor i nënshtruar është budalla apo përtacë). Në secilin rast, stereotipi është një përgjithësim që nuk llogarit ndryshimet e gjithësecilit.



PARAGJYKIM:

Paragjykimi i referohet besimeve, mendimeve, djenjave dhe sjelljeve që dikush ka ndaj një grupi. Një paragjykim nuk është i bazuar në përvojë; përkundrazi është një gjykim i parakohëshëm. Racizmi është një lloj paragjykimi që përdoret për të justifikuar besimin se një kategori racore është në një farë mënyre superiore apo inferiore ndaj të tjerave. Klux Klan është shembulli i një organizate raciste. Besimi i anëtarëve të saj në supremacinë e bardhë ka inkurajuar prej më shumë se një shekulli krimet dhe gjuhën e urrejtjes.

DISKRIMINIM:

Ndërkohë që paragjykimi i referohet të menduarit paragjykes, diskriminimi konsiston në veprime ndaj një grupi apo kategorie njerëzish. Diskriminimi ndodh kur disa njerëz trajtohen në mënyrë më pak të favorshëm se disa njerëz të tjerë, vetëm sepse ata i përkasin apo mendohet se i përkasin një grupi apo kategorie të caktuar njerëzish.

Diskriminimi ndryshon nga paragjykimi dhe stereotipi pasi ai nuk është një aplikim i një besimi (Fiske, 2010). Një shembull i diskriminimit është një femër e cila nuk e mer vendin e punës sepse punëmarrësi donte një mashkull për atë pozicion. Njerëzit mund të diskriminohen për shkak të moshës, përkatësive, etnicitetit, origjinës, besimit politik, fesë, racës, seksit apo gjinisë, orientimit seksual, gjuhës kulturës dhe shume aspekteve të tjera.

GJUHA E URREJTJES:

Gjuha e urrejtjes përcaktuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mbulon të gjitha format e të shprehurit të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen rracore, ksenofobinë, antisemitizmin apo forma të tjera të urrejtjes bazuar në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nëpërmjetë nacionalizmit agresivë dhe etnocentrizmit, diskriminimin dhe armiqësinë ndaj minoriteteve dhe migrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante. Për qëllimin e fushatës, të tjera forma të diskriminimit dhe paragjykimit të tilla si anti-xhipsizim, kristianofobi, islamofobi, misogjinia, seksizmi dhe diskriminimi në aspektet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor qartazi përfshihen në gjuhën e urrejtjes.



LËVIZJA KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES

Lëvizja kundër gjuhës së urrejtjes nisi në Mars 2013 dhe është një pjesë kyçe e përpjekjes së këshillit të Europës për të promovuar të drejtat e njëriut online. Lëvizja lindi pasi Këshilli i Europës pranoi se gjuha e urrejtjes përbën një kërcënim ndaj të drejtave të njëriut dhe ndaj demokracisë. Pavarësisht se u krijua si një front kundër gjuhës së urrejtjes, lëvizja qartësisht njihet dhe mbështet të drejtën e lirisë së shprehjes. Në këtë mënyrë lëvizja promovon përgjigjen ndaj gjuhës së urrejtjes të fokusuar në edukim, fushata ndërgjegjësimiti, punën me viktimat duke edukuar kështu zhvillimin e vetërregullimit ndërmjet njerëzve të cilët rrezikohen nga gjuha e urrejtjes.

Lëvizja kundra gjuhës së urrejtjes ka për qëllim të promovojë të drejtat e njëriut online, të inkurajojë aktivizimin kundra gjuhës së urrejtjes dhe të kontribuojë në bërjen e internetit dhe të botës një vend ku çdo kush mund të ndihet i parrezikuar nga urrejtja dhe frika.

STEREOTIPET: CILËT JANË EFEKTET?



STEREOTIPET NEGATIVE MUND TË ÇOJNË NË PARAGJYKIM

Rëndësia e të kuptuarit dhe të luftuarit kundër stereotipeve njihet prej kohësh nëpërmjet një mori studimesh të kryera mbi këtë çështje. Kuptohet që stereotipet negative kanë marrë një vëmendje të veçantë. Për shëmbull, një studim i kryer nga universiteti "College of London" zbuloi që truri njerëzor është i predispozuar t'i mësojë stereotipet negative. Ky studim ofron fakte sesi paragjykimi lind dhe shpërndalet në shoqëri. (Spiers, Bradley, Love, Le Pelley, Gibb&Murphy, 2016).

Studimi zbuloi se truri i përgjigjet me më shumë forcë informacionit rreth grupeve të cilët portretizohen si më pak të favorizuar, duke e vendosur theksin tek fakti që përshkrimi negativ i minoriteteve etike apo fetare në media mund të nxisë paragjykimet racore. Duke marrë parasysh paragjykimet dhe mbështetjen që po marrin politikanët e të djathtës ekstreme në botën perëndimore gjatë viteve të fundit, përfundimet e këtij studimi meritojnë më tepër vëmendje.

Shtimi i paragjykimit sot, është ndoshta më i dukshëm me përhapjen e postimeve kundër muslimanëve në internet dhe në media, shpesh duke i portretizuar muslimantët si terrorist. Këto stereotipe negative çojnë në paragjykimet kundër muslimanëve dhe kontribuojnë në rritjen e ndjenjës antimuslimane.

Një tjetër stereotip i zakonshëm është ai i njerëzve me ngjyrë në SHBA. Amerikanët me ngjyrë shpesh portretizohen si të dhunshëm në mediat amerikane dhe si të predispozuar ndaj krimit. Ky stereotip ka sjellë shume vuajtje për amerikanët me ngjyrë përballë një sistemi gjyqësor i cili shpesh i trajton qytetarët me ngjyrë me një paragjykim të jashtëzakonshëm, shpesh duke i dënua me dhunë policore dhe burgosje të tepruar në raport me njerëzit e bardhë.

Duke u përballur në mënyrë të përsëritur me stereotipet negative, njerëzit mund të ngecin në një fluskë ku ata shohin vetëm anën negative tek të tjerët siç është rasti i sipërpërmendur. Në mënyrë të pashmangshme kjo çon në rritjen e paragjykimit dhe mosbesimit tek tjetri dhe për pasojë rritjen e racizmit, ekstremizmit dhe konfliktit.

Shpërthimi i paragjyqimeve dhe politikave ekstreme gjatë viteve të fundit vjen si pasojë e përfshirjes së njerëzve në mediat sociale. Mediat sociale kanë sjellë si pasojë një numër në rritje të njerëzve të cilët ekspozohen ndaj stereotipeve negative të personave, të cilët ata nuk i kanë takuar asnjëherë dhe si rrjedhojë janë më të predispozuar për të paragjykuar të tjerët.



SI E SHOFIM VETVETEN?

Ne jo vetëm që etiketojmë, kategorizojmë dhe krijojmë stereotipe për grupet e tjera, por gjithashtu krijojmë stereotipe për grupet ku bëjmë pjesë. Kjo quhet “autostereotip”. Ne priremi të shofim grupin tonë në një këndvështrim pozitiv. Mendoni për një moment sesi shqiptarët mendojnë për veten e tyre...

Nëse ju kërkohet të listoni stereotipet që shqiptarët kanë për bashkatdhetarët e tyre çfarë do të thonit?

Përgjithësisht njerëzit do të thonë se ata besojnë që shqiptarët janë mikpritës me miqtë, që janë pasionant dhe trima etj. etj. A besoni se çdo stereotip pozitiv që keni listuar është i vërtet për çdo shqiptar që ju njihni?

Duke zbuluar mënyrën me të cilën krijojmë stereotipe për veten tonë dhe se si grupi jonë fetarë apo kombëtarë përfshihet në një stereotip mund të fillojmë të kuptojmë kufizimet dhe problemet që krijimi i stereotipeve mund të shkaktojë midis grupeve të ndryshme me stereotipe të ndryshme për njëri tjetrin.

NDIKIMI I PARAGJYKIMIT NË JETËN INDIVIDUALE

Paragjykimi është një prirje personale apo temperament i bazuar në një gjykim jo të arsyeshëm ose besim. Paragjykimi mund të reflektohet në sjellje (verbale, joverbale ose të shkruar) kërcënuese, ngacmuese, frikësuese, diskriminuese, poshtëruese e cila bazohet në identitetin real apo të perceptuar të një personi apo përkatësisë së një grupi, duke përfshirë racën, moshën, statusin e paaftësisë, gjininë, identitetin gjinor, kombësinë, orientimin seksual ose besimin fetar.

Duhet të jesh një person i fortë për t'i bërë ballë paragjykimit. Personat që bien viktimë e paragjykimeve, stereotipeve dhe diskriminimeve sillen në mënyra të ndryshme të tilla si; disa kalojnë në depresion dhe mbyllen në vetvetë, kurse të tjerët i dorëzohen stereotipeve, shpesh duke besuar që stereotipet pozicionohen kundra tyre ose të tjerëve (Rivers, et al.). Ndërkohë që është e kuptueshme se si paragjykimet, stereotipet dhe diskriminimet e çojnë individin në një vetvlerësim të ulët, në probleme mendore, depresion dhe çrregullime të tjera. Nuk janë vetëm këto pasoja

(Sinclair & Kunda, 1999). Personat që nuk bien viktimë e paragjykimeve, shpesh i përdorin keto rrethana si faktorë motivues (Sinclair & Kunda, 1999). Lëndimin, degradimin, nënvlerësimin dhe pengimin, këta persona i përdorin për ta shtyrë veten drejt tyre. Ata mund të vuajnë në momente negativiteti, por ata nuk lejojnë që ky negativitet të zgjasë e t'i konsumojë. Personat të cilët janë mjaftueshëm të fortë për t'i bërë ballë të keqes, shpesh udhëhiqen nga një dëshirë për të vërtetuar të kundërtën e stereotipit (Fiske, 2000).

'TJETËRSIMI'

Tjetërsimi është procesi i vendosjes së një grupi, individi apo objekti në rolin e "tjetrit", dhe krijimin e identitetit të vet nëpërmjet kundërshtimit dhe shpesh, shpifjes karshi "tjetrit".

Kur ne i kategorizojmë njerëzit si "të tjerë", ne fillojmë t'i shohim ata si të ndryshëm nga vetja jonë. Procesi i tjetërsimit krijon një distancë midis nesh dhe tjetrit. Tanimë ne nuk e shikojmë veten si të barabartë por si të huaj, të çuditshëm, të vegël.

SHEMBULL:

Kur dy shtete janë në konflikt me njëri-tjetrin për territore apo ideologji, ata e shofin veten si superior dhe demonizojnë njëri-tjetrin pavarësisht besimit apo verpimeve personale. Kjo krijon ndarje të mëtejshme ndërmjet dy shteteve dhe gjeneron tensione që mund të rezultojnë në diskriminim, gjuhë urrejtjeje dhe madje edhe dhunë.

GJUHA E URREJTJES DHE PASOJAT E SAJ


Gjuha e urrejtjes mund të ndodh në rrethana të ndryshme, kryesisht në kontekstet “ne” dhe të “tjerët” e cila kryesisht buron nga paragjykimet dhe stigmat sociale. Gjuha e urrejtjes e ka prejardhjen nga “legjitimiteti” i dallimit të njerëzve nga grupe të caktuar, si inferior ndaj “nesh”, duke u bazuar në ngjyrën e lëkurës, fenë, etnicitetin, orientimin seksual etj.. Shpesh këto kritere janë shumë subjektive, si në rastin e ngacmimeve që vijnë nga perceptime personale. Gjuha e urrejtjes shpesh përcaktohet nga kontekstet sociale dhe historike, ku përfaqësuesit e grupeve që janë në objektin ose përbëhen nga një grup i marginalizuar ose janë të përfshirë në një histori të dhunshme.

Po t’i referohemi fjalëve të Nelson Mandelës, “njerëzit mësojnë se si të urrejnë”, në të vërtetë ne mësojmë se si të jemi më superior kundrejt grupeve të caktuara sociale në ambientin ku jetojmë, familjet, miqtë, mediat dhe kontekstin politik. Shpesh kur nuk kemi një kontakt personal me njerëzit nga grupi që nuk pëlqejmë, kemi frikë nga e panjohura dhe kur ndihemi të rrezikuar, frika, si një reagim i natyrshëm, shpesh na shoqërohet me agresion dhe urrejtje. Këto fenomene

përdoren gjërësisht nga mediat populiste që ndërtojnë frikërat “popullore” tek të tjerët: në kontekstin modern mund të kuptojmë me lehtësi se si refugjatët në Europë shikohen si grupe armiqësore për shkak të perceptimit të rrezikut, të shpërndarjes kulturore, rritjes së shkallës së krimit, papunësisë etj.

Fjalët lëndojnë më shumë se ngacmimet dhe pasojat e gjuhës së urrejtjes mund të jenë shumë traumatike: në nivel personal duke u përshkallëzuar në ndjenjat e izolimit, depresionit madje në rastet më dramatike deri në tentativë për vetëvrasje, ndërkohë që në nivel komuniteti zakonisht gjuha e urrejtjes ndërton rrugën drejt krimit, të tilla si shkatërrim prone dhe sulmeve fizike. Hitoria e luftës së dytë botërore mbart shembuj tragjik të genocidit si pasoja shumë të mëdha të gjuhës së urrejtjes dhe dehumanizimit të grupeve të tëra popullatash të tilla si Hebre, Roma, LGBT etj.

Gjuha e urrejtjes ka rrënjë të thella në shoqëri dhe buron nga stereotipet, paragjykimet, racizmi dhe diskriminimi, ashtu siç mund ta shikoni edhe në figurat më poshtë.





IDENTIFIKIMI I STERIOIPEVE

Steriotipet janë përreth nesh. Ata na ndihmojnë të kategorizojmë dhe deshifrojmë, për të vendosur një farë rregulli në një botë komplekse. Gjithsesi, për të menduar në mënyrë kritike, kur përballemi me stereotipe negative të cilat mund të na drejtojnë në paragjykim dhe diskriminim, ne duhet të krijojmë aftësi për t'i identifikuar këto stereotipe online dhe offline.

Të gjitha format e medias, qofshin këto shfaqje televizive, filma apo gazeta dhe reportazhe, shpesh përdorin dhe promovojnë stereotipe negative për të treguar histori. Në të gjitha tentakulat që media ka kapur, stereotipet hynë në mënyrën e tyre në jetët tona duke i ndotur ekranet, duke ulëritur nga folësit dhe duke na përshëndetur me dorë në bashkëbisedimet tona të përditshme. Fatkeqësisht për çdo lajm flesh, është shumë e lehtë të besosh tek historia e stereotipeve të mirënjohura, sesa të rrëmosh në përshtjellimin, mjedisin apo situatën e një grupi njerëzish të posaçëm. Bëhet e pamundur për ne të mësojmë se si të identifikojmë stereotipet që përdoren nga mediat kështu që ne duhet të bëhemi mendjemprehtë dhe objektivë për informacionin që marrim.

Në lajme, persona të veçantë të shoqërisë sonë shpesh shfaqen në mënyra të veçanta, për shembull gra të spikatura që e seksualizojnë hapur sjelljen e tyre. Gratë pavarësisht profesioneve dhe meritave që kanë, në sytë e publikut shpesh gjykojnë në bazë të appearanceve të tyre, ndërsa meshkujt i shpëtojnë kësaj kritike. Kjo e forcon idenë që gratë duhet të shikohen si objekt seksual në "sytë e meshkujve" dhe nuk kanë për të qënë asnjeherë të barabarta me ta.

Kur publiku bombardohet vazhdimisht me stereotipe të tilla si gra të dobëta dhe që tërheqin seksualisht, fillojmë ta përvetësojmë këtë këndvështrim dhe t'i paragjykojmë por madje edhe t'i diskriminojmë duke i parë ato si gra me aftësi të ulta dhe jo të barabarta me burrat.

Një shembull tjetër i spikatur i krijimit të stereotipeve të medias në Europë mund të gjendet tek refugjatët e vendeve në luftë që kërkojnë azil. Portalet e lajmeve online, gazetave dhe njoftimeve në televizion transmetojnë mbërritjen e qindra njerëzve në varka të tejmbushura nga Afrika veriore dhe Lindja e Mesme, duke treguar turma njerëzish të dëshpëruara që ankohen. Titujt shpeshë janë të bujshme dhe nxitëse duke i përshkruar turmat si 'vërshuese' dhe 'pushtuese' ndaj Europës. Në këtë mënyrë media e dehumanizon këtë grupë njerëzish. Ata e përjetësojnë idenë që të gjithë refugjatët janë të rrezikshëm, terrorist, të dhunshëm që kanë për qëllim të shkatërrojnë jetët tona.

Aktualisht kjo pikëpamje negative për refugjatët është e pakontrolluar në mediat tona. Më mirë se sa të flasim për vështirësinë e këtyre njerëzve, është më e lehtë dhe më dramatikë për nxjerrjen e lajmeve për të prodhuar një vërsion historik më të thjeshtë sesa për të prodhuar paragjykim. Stereotipet negative të refugjatëve kanë një efekt dramatik në popullsinë e të gjithë kontinentit dhe kjo ka çuar në rritjen e grupeve politike të djathtë dhe organizatave që mbështesin shpërthimet e gjuhës së urrejtjes ndaj refugjatëve dhe fesë islame.

SHEMBULL:



Filmi "Taken" (2008) paraqet një linjë historie për një ish agjent të guximshëm amerikan i CIA (Liam Neeson) në ndjekje të rrëmbimit të vajzës së tij nga një bandë e rrezikshme trafikantësh nga Shqipëria. Drejtuesi i keq i bandës, Marko nga Tropoja (Arben Bajraktashi) është personifikimi kryesor i stereotipit të shqiptarëve në film si kriminela të këqinj. Afrikanë-amerikanët gjithashtu janë kthyer në stereotipa në filmat Hollivudian si shpërndarës droge apo gangsterë të rrezikshëm. Interpretimi i vazhdueshëm i këtyre grupeve njerëzish mund të ndikojë në mënyrë të veçantë mënyrën sesi në i perceptojmë grupet. Nëse shpesh prezantohemi me imazhet e amerikanëve zezak si kriminela, ne fillojmë të formojmë një besim se të gjithë zezakët amerikanë janë gangsterë dhe banditë. Portrete të tilla për grupe të caktuar njerëzish rrallë zbulojnë faktorët historikë, socio-ekonomikë dhe vështirësitë e tjera që mund të kenë çuar në arsyen pse dikush është bërë kriminel. Filmat gjithashtu rrallë na tregojnë praktikën diskriminuese sistematike që bëjnë jetën e grupeve minoritare/ njerëzve të racave të ndryshme, besimeve të ndryshme etj, më të vështirë. Është e rëndësishme ta kujtoni këtë gjë kur shikoni filma apo programe televizive!

Gjithashtu është e rëndësishme të kujtoni kur shikoni TV apo filma të tilla ku portretizohen grupe të tilla njerëz.

KORNIZA LIGJORE

Për të realizuar parimin e barazisë, nuk mjafton vetëm që shteti të shpallë ndalimin e diskriminimit, por është e domosdoshme që të krijohet një sistem efikas dhe i fuqishëm, ligjor për diskriminimin. Ashtu si shtetet e tjera, edhe shteti jonë ka krijuar mekanizma ligjor të cilët mund të përdoren në rastet e diskriminimit. Këta mekanizma janë si më poshtë:

-Proçedura para Komisionarit për mbrojtjen e barazisë sipas ankesave për shkak të diskriminimit.

-Proçeset gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi.

-E drejta penale për mbrojtjen nga diskriminimi.

-Mbrojtja ligjore për kundërvajtje të diskriminimit.

- Në nenet 16,18 dhe 20 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet dënimi ndaj diskriminimit.
- Në nenin 18 parashikohet se “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale apo përkatësia prindërore”.
- Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, konkretizon nenin 18 të Kushtetutës. Ai është ligji organik mbi bazën e të cilit sigurohet mbrojtja nga diskriminimi. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.
- Ligji “Për mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon detyrimin e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit për marrjen e masave pozitive për të nxitur arsimimin e pakicave apo vajzave, që do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në nivelin e arsimimit të këtij komuniteti.
- Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar krijimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kompetencat e të cilit janë në përputhje me Direktivën 2006/54/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Europës, i cili në nenin 20 parashikon se këto organe ndër të tjera duhet të sigurojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit përmes trajtimit të çështjeve apo asistencës në gjykatë.
- KMD III. Krijimi i kuadrit institucional për mbrojtjen e të drejtave të romëve në Shqipëri. Shqipëria tashmë ka hartuar një legjislacion në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe ka krijuar mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi të komunitetit Romë.
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial - CERD, në të cilën Shqipëria ka aderuar në vitin 1994. Konventa përcakton detyrimin e shteteve palë të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre, origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave.



- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në 1996 (Ligji Nr. 8137/1996), në nenin 14 të saj parashikon “ndalimin e diskriminimit”. Protokolli Nr. 12, në nenin 1, i referohet ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit, duke zgjeruar fushën e zbatimit të nenit 14 edhe në rastet kur një person është diskriminuar, në gëzimin e çdo të drejte ose përfitimi sipas legjislacionit kombëtar.
- Sigurisht që një vend thelbësor zë ratifikimi pa asnjë rezervë nga Shqipëria e Konventës Kuadër Këshillit të Europës Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Kjo Konventë ka qëllim themelor sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo konventë ndalon çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare, duke përcaktuar detyrimin për palët nënshkruese të kësaj konvente, që t’iu garantojnë personave që iu përkasin pakicave kombëtare të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtës së barabartë nga ligji
- Karta Sociale Evropiane, një traktat i Këshillit të Europës, e miratuar në vitin 1961 dhe e rishikuar në vitin 1963, është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm me ratifikimin e saj prej Shqipërisë në vitin 2002. “Çdo diskriminim bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, etnia, origjina etnike apo shoqërore, gjuha, feja apo besimi, bindjet politike ose bindje të tjera, përkatësia në një minoritet kombëtar, vendbanimi, lindja, aftësia e kufizuar, moshë, orientimi seksual duhet të ndalohet”.

KAPITULLI 2: TË DHËNAT NGA STUDIMI NË TERREN

STEREOTIPET NË SHQIPËRI

REZULTATE

Matja e perceptimeve tek të rinjve si dhe niveli i informacionit rreth stereotipeve, paragjykimeve dhe diskriminimit, si dhe gjuhës së urrejtjes janë elementë të rëndësishme për të kuptuar situatën dhe për të krijuar plan veprime apo aktivitete në të ardhmen.

Këto të dhëna mund të na orientojnë ne, partnerët, organizatat e tjera, institucionet arsimore, mediat, etj, në rastet kur është e nevojshme për të luftuar stereotipet dhe si mund të kontribuojë secili nga ne në këtë "luftë".

Ky kapitull paraqet disa të dhëna të mbledhura nëpërmjet:

-Pyetjeve gjatë procesit të seleksionimit të pjesëmarrësve në trajnim, ku i janë përgjigjur 217 të rinj të moshës 18-30 vjeçare.

-25 intervista, pyetësorë, para testime dhe observimeve që u bënë me të rinjtë e përzgjedhur për trajnimin 1 javor.


-100 pyetësorë gjysëm të strukturuar, të plotësuar nga të rinjtë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme në rrugë, kafene, shtëpi, shkollë, universitete. Pyetësorët janë plotësuar gjatë dhe pas trajnimit nga të rinjtë pjesëmarrës në trajnim.

PERCEPTIMET E TË RINJVE


Përkufizimet dhe perceptimet personale

Nga të dhënat e mbledhura, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve nuk e kanë të qartë përkufizimin dhe dallimin ndërmjet stereotipeve, paragjymieve dhe diskriminimit. 43.4% e të rinjve mendojnë se stereotipizimi është besim dhe rreth 49% e konsiderojnë stereotipin sjellje ose veprim. 45.3% mendojnë se paragjykimi është një sjellje dhe rreth 49% e kategorizojnë si besim apo veprim. Diskriminimin si veprim e perceptojnë rreth 39.5% e të rinjve dhe një pjesë jo e vogël (50.9%) e kategorizojnë si sjellje. Pra duke i parë përgjigjet në tërësi ka të rinjë që i kategorizojnë stereotipet dhe diskriminimin edhe si sjellje, edhe si besim edhe si qëndrim. Por ka edhe nga ata që janë konfuzë me termat për shkak të mungesës së informacionit. Por në rast se do i referohemi pyetjes se a ka ndryshim ndërmjet këtyre 3 termave, janë rreth 94.3% që mendojnë se po.

Grafik 1: Cfarë kuptoni me termin steriotip




Grafik 2 Cfarë kuptoni me termin paragjykim




meta-chart.cc

Grafik 3: Cfarë kuptoni me termin diskriminim



meta-chart.

Grafik 4: A ka ndonjw ndryshim ndwrmjet ketyre termave



meta-chart.com


Të intervistuarit kanë ide jo shumë të qarta për sa i përket përkufizimit të gjuhës së urrejtjes. Ky konsiderohet një term relativisht i ri për të rinjtë shqiptar dhe është vënë re nevoja për më shumë informacione dhe raste konkrete.

Nga sa vihet re, janë rreth gjysmat e të anketuarve, të cilat i konfuzojnë këto terma. Rrjedhimisht, kjo bën që dhe identifikimi i rasteve konkrete apo reagimi i të rinjve ndaj stereotipeve apo diskriminimit do të jetë i ulët. Në rast se ky anketim do të kishte shtrirje më të gjerë, në mënyrë të veçantë të fokusuar më shumë tek të rinj nga zona më të largëta të Shqipërisë apo zona rurale, ku informacionet janë më pak të arritshme, atëherë këto të dhëna do të ndryshonin.

Stereotipet dhe diskriminimi janë fenomene që prekin shtresa të ndryshme dhe ndonjëherë nuk mund të shpëtojmë nga këto fenomene, duke qënë se jemi qenie njerëzore. Nga të intervistuarit 54.7% janë ndjerë të diskriminuar gjatë jetës së tyre.


'CDO NJERI ËSHTË STEROTIPIZUAR OSE PARAGJYKUAR NË SHUME RASTE...PËR SHEMBULL, UNË MUND TË JEM ETIKETUAR SI NJË VAJZË E DOBET APO E NDJESHME VETËM PËR FAKTIN QË JAM FEMER PA MË NJOHUR ASPAK MUA APO JETËN TIME. JAM ETIKETUAR MË EMËRTIME FYTËSE NGA NJERËZ QË AS MË NJIHIN E AS I NJIHJA. OSE JAM DISKRIMINUAR SI PASOJË E DESHIRËS SIME PËR TË PRAKTIKUAR ISLAMIN.'

Grafik 5: A jeni ndjerë ndonjëhere të diskriminuar?



meta-chart

Grafik 6: A keni stereotipizuar ndonjëhere?



meta-chart.co



Pjesa më e madhe e anketuesve dhe intervistuesve mendojnë se janë stereotipizuar, paragjykuar apo diskriminuar nga persona apo grupe të ndryshme. Të indentifikosh dhe pranosh këto fenomene është një proces dhe tregues pozitiv, në rastet kur kemi të bëjmë me reduktimin e diskriminimit.

'ZAKONISHT, PËRVEÇ KURESHTJES NJERIU KA DY SJELLJE TË CAKTUARA KARSHI ASAJ QË NUK NIJH: ËSHTË FRIKA DHE PARAGJYKIMI. NJERËZIT MENDJENGUSHTË E ME PAK HORIZONT APO INJORANT, ZGJEDHIN TË PARAGJYKOJNË. E TILLË KAM QENË EDHE UNË NË NJË HERË E NJË KOHË. SHUMË GJERA I MERRJA TË GATSHME NGA AMBIENTI NË TË CILIN JAM RRITUR... E KAM FJALËN PËR MENDIME TË CAKTUARA PËR PERSONA OSE GRUPE TË CAKTUARA. POR ASNJEHËRE NUK KAM DISKRIMINUAR.'

'PËRGJITHËSISHT PARAGJYKIMET 'POLITIKE', RASTET KUR TAKON EMIGRANT QË VIJNË NGA GREQIA APO VAJTJA NË SERBI, DOLEN KOMPLET TË GABUARA.'

Në rast se do të hedhim një vështrim, se cilat janë grupet që diskriminohen më shpesh, nga të dhënat rezulton se komuniteti i LGBT janë më shumë të diskriminuar, duke vijuar më tej me Romët dhe Egjiptianët, gratë dhe vajzat, personat me aftësi të kufizuar dhe të moshuarit. Për secilin nga këto grupe ka perceptime të ndryshme, por nga rezultatet duket sikur homofobia është një çështje shumë aktuale dhe personat LGBT vazhdojnë të përballen me diskriminime në ambientet ku ata jetojnë dhe punojnë.

Gjatë trajnimit të rinjtë patën mundësi të marrin informacione rreth diskriminimit të të gjitha këtyre grupeve. Si fillim kanë qënë diskutime të lira dhe pyetje, nga ku u vu re se paragjykimet ishin të pranishme tek pjesa më e madhe e të rinjve. Më pas gjatë trajnimit kanë qënë të ftuar përfaqësues të ndryshëm të këtyre komuniteteve, ku kanë ndarë historitë e tyre personale, sfidat që ndeshin, mënyrat si ndihen në një shoqëri mospranuese, etj. Pas këtyre takimeve është vënë re ndryshim i perceptimeve dhe qëndrimeve të të rinjve kundrejt këtyre komuniteteve.

Për të parë në mënyrë më konkrete perceptimet e të rinjve në lidhje me komunitete të ndryshme ju është lënë të plotësojnë disa pohime si të vërteta apo të rreme.

PSE STEREOTIPIZOJMË DHE CILAT JANË DISA NGA FORMAT

Formimi i stereotipeve, paragjytimeve dhe diskriminimit vijnë nga arsye shumë të ndryshme. Të rinjtë e përfshirë në këtë studim rendisin së tepërmi mungesën e informacionit, që individët kanë ndaj grupeve të ndryshme apo individëve që konsiderohen të ndryshëm nga shumica e popullsisë. Gjithashtu janë rreth 75% e të rinjve që mendojnë se ne krijojmë stereotipe për shkak se duam të jemi superior ndaj të tjerëve.

Arsye të tjera si: mentaliteti, kultura, mënyra se si familja na edukon, të ndjerit inferior, egoizmi, etj, janë pjesë të natyrës njerëzore.

'MENDOJ SE KY ËSHTË MODELI QË KANË MARRË NGA FAMILJA. MËNYRA SE SI PRINDËRIT KANË FOLUR RRETH NJERËZVE TË CAKTUAR, U KA TREGUAR FEMËJEVE TË TYRE SE INDIVIDET SHIHEN NGA GRUPI QË I PËRKASIN DHE JO SI INDIVIDË UNIKE.'

EFEKTET

75.5% e të intervistuarve mendojnë se stereotipet dhe diskriminimi nuk kanë efekte pozitive, ndërsa një pjesë shumë e vogël (7%) mendojnë se ka edhe efekte pozitive. Gjithashtu, 92% mendojnë se stereotipet kanë efekte negative.

Disa nga efektet negative të listuara janë: çrregullimet psikologjike, ulje vetëbesimi, humbje potenciali për ndryshim/zhvillim dhe në tërësi një shoqëri të zbehtë pa ngjyra diversiteti;


'PËRGJITHËSISHT PARAGJYKIMET 'POLITIKE', RASTET KUR TAKON EMIGRANT QË STEREOTIPIET, PARAGJYKIMET DHE DISKRIMINIMI KRIJONË MURE, TË CILËT NA PENGOJNË TË SHOHIM NJERËZIT RRETH NESH PËR ATË ÇKA VLEJNË REALISHT, DUKE U HEQUR PARALELISHT ATYRE DHE VETES TONË MUNDËSINË PËR TË BASHKËPUNUAR MË EFIKASITËT, KRIJUAR RAPORTE TË SUKSESSHME DHE JETUAR NË HARMONI.'

Stereotipet, paragjykimet, diskriminimet i hapin rrugë negativitetit: urrejtjes, luftrave, vrasjeve, etj.

Janë 77% e të rinjve, të cilët mendojnë se stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimi sjellin përçarje të mëdha në shoqëri. Është një numër i pakonsiderueshëm i atyre që mendojnë se këto fenomene nuk sjellin përçarje.

SEPSE E NDAN IMAZHIN E SHOQËRISË SI FILLIM NË KOKËN TËNDE DHE PASTAJ, DUKE E IMPONUAR MËNYRËN TËNDE TË TË MENDUARIT TEK TË TJERËT, E USHTROJNË DHE ATA DHUNEN TEK TË TJERËT DHE PËRÇARJA E SHOQËRISË NË GRUPE DO TË PASOJË DOMOSDOSHMERISHT SI RRJEDHOJE.

Grafik 7: A sjell përçarje ne shoqëri diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes ?



meta-chart.co

Ndoshta, tashmë ndodhemi në situatën ku të rinjtë janë të ndërgjegjshëm ndaj efekteve që sjellin stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimi. Rritja e ndërgjegjësimit, pranimi dhe më pas njohja e paragjytimeve që ne kemi na ndihmojmë ti reduktojmë në nivel personal dhe pse jo të kontribuojmë në nivel shoqëror si individë aktiv.

STEREOTIPET NË MEDIA



Media vizive, e shkruar dhe ajo sociale ka një rol të rëndësishëm në shpërndarjen dhe forcimin e stereotipeve, apo në reduktimin e tyre.

Bazuar në përgjigjet e dhanë gjatë intervistave dhe pyetësorëve të realizuar, mediati sociale zënë vendin primar për shpërndarjen e stereotipeve. Më pas vijnë emisionet televizive dhe filmat. Janë më të pakta rastet ku të rinjtë kanë identifikuar stereotipe apo paragjykime në libra.

Të rinjtë e përfshirë në këtë studim kanë identifikuar një sërë filmash, emisionesh, etj, ku stereotipet janë të shpërndara në forma nga më të ndryshmet, si psh:

STEREOTIPET PËR ROMËT QË JANË DEBELA, GREKET QË JANË TË GJITHË GAY, STEREOTIP PËR SERBËT OSE RUSËT QË JANË RACISTA, PËR AMERIKANËT QË JANË AJKA E SHOQËRISËS GLOBALE DHE SHUMË MENDJEHAPUR, STEREOTIPI QË KINEZËT NUK DIJNË TË NGASIN MAKINAT; STEREOTIPI QË MESHKJUT GAY JANË SI FEMRA DHE ANASJELTAS PËR LEZBIKET, ETJ.

!MYSLIMANËT JANË TË RREZIKSHËM. IZRAELITËT JANË ÇIFUTË, ETJ, ETJ...

VAJZAT E BUKURA PREZANTUESE, DJEMT E ZGJUAR PREZANTOJNË EMISIONE SERIOZE.!

!MYSLIMANËT JANË TË RREZIKSHËM. IZRAELITËT JANË ÇIFUTË, ETJ, ETJ...

MUNGESA E GRAYE NË POLITIKË, NË SPORTE, NË BISEDË POLITIKE, NË TEMAT QË LIDHEN ME SEKSUALITETIN ATA QË SHPREHEN MË HAPUR DHE PË DORASHKË SHPESH JANE BURRË, KUR GRATË E BEJNË KËTË GJË DIREKT PËRFLITEN EDHE OFËNDHEN. NË TEMAT QË FLITËT PËR FAMILJEN, KUIDESIN NOAJ FEMIEJEVE, PUNËT E SHTËPISË, ETJ, ZAKONISHT JANË TË FTUARA GRATË.!

ROLI I TË RINJVE DHE INSTITUCIONEVE

Nga intervistat e bëra, të rinjtë e konsiderojnë rolin e tyre si ambasadorë, që mund të sjellin ndryshim, për ta parë shoqërinë ashtu siç e duan atë në të ardhmen. Roli i të rinjve perceptohet në të qëniet të informuar, të ndërgjegjshëm dhe aktiv për t'i luftuar këto fenomene. Organizimi i sa më shumë aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese, ndikon në mënyrë direkte në bërjen e të rinjve faktor të rëndësishëm në luftën ndaj diskriminimit.

Gjithashtu, të rinjtë mendojnë se angazhimi i tyre më i madh duhet të jetë në organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit, organizimin e workshopeve, marrjen pjesë në trajnime me këtë temë, të takojnë përfaqësues nga komunitete të ndryshme, të vullnetarizojnë më shumë, të jenë më shumë mendjehapur, etj.

SE PARI TË RINJTË DUHET TË NDËRGJEGJËSOHEN PËR VEPRIMET DHE MENDIMET E TYRE, DUKE QENË SE TË MENDUARIT SE DIKUSH ËSHTË NDRYSHË I BËNË DHE ATA NDRYSHË. DUHET TË ZHVILLOHEN FUSHATA NDËRGJEGJËSIMI NGA TË RINJTË PËR TË RINJTË.

!ORGANIZIMI I FUSHATAVE PËR NDËRGJEGJËSIMIN E INDIVIDËVE NË LIDHJE ME PASOJAT E STEREOTIPEVE, PARAGJYKIMEVE DHE URREJTJES; SHPËRNDARJA E MESAZHEVE MBI TOLERANCËN ETJ.!

KJO GJË FILLON QË NË VEGJËLI. NDAJ NJË MËNYRË E MIRË DO TË ISHTE TË KRIJOHESHIN LIDHJE MË TË FORTA MIDIS NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË NDRYSHME NËPËRMJET AKTIVITETEVE. NXËNËSIT DO TË NDËRVEPRONIN ME TË RINJ NGA GRUPE TË NDYSHME SOCIALE, ME DËSHIRA E FORMIME TË NDYRSHMË GJATË ZHVILLIMIT TË OREVE TË DEBATIT PËR TEMA TË TILLA. FITORJA MË E MADHE ËSHTË HAPJA NDAJ GJERAVE TË REJA E TË NDYRSHME.

Kur vijmë në pyetjen, se konkretisht çfarë do të bënte secili prej tyre për të luftuar këto fenomene, përgjigjet janë shumë të përgjithshme, jo të qarta dhe aspak specifike.


'ËSHTË SHUMË E VËSHITRË TË MUNDOHESH TË NDREQËSH NJË POPULL TË IZOLUAR PËR SHUMË DEKADA DHE T'A UDHËZOSH DREJT MENTALITETIT PERËNDIMOR. FUSHATAT SENSIBILIZUESE MENDOJ QË MBETEN MË E PAKTA QË MUND TË BËHET. PARAGJYKIMI ËSHTË NJË FENOMEN QË KA VITE QË LUFTOHET NË SHQIPËRI.'

TË KRIJOJA NJË BLOG DUKE QENË SE TË RINJTË JANË TË DHËNË PAS INTERNETIT, TË FLISJA ME MIQTË PËR TË NDËRGJEGJËSUAR SA MË SHUMË TË TJERËT.

Nga të dhënat sasiore të mbledhura, kur të rinjtë pyeten se cilat janë disa prej rrugëve që reduktojnë diskriminimin, 45% e tyre mendojnë se trajnimet janë mënyra më e mirë.

Ndërsa si institucionet më të rëndësishme ata shohin shkollat, individin, universitetet dhe më pas median.


Grafiku 8: Rendisni cilat janë mënyrat kryesore të reduktimit të këtyre fenomeneve




REAGIMI

Edhe pse nga të dhënat rezulton se 75.5% janë në gjendje të identifikojnë gjuhën e urrejtjes, 45% janë përgjigjur se nuk do të bënin asgjë në rast se do të përballeshin me të. Aktivizimi qytetar ngelet akoma një pikë kritike, sidomos për të rinjtë. Këta të fundit kanë një rol kyç në marrjen e informacionit dhe raportimin apo adresimin ndaj fenomeneve negative. Informacioni më i thelluar dhe rritja e ndërgjegjësimit mund të jenë disa nga mjetet për të rritur reagimin qytetar

Grafiku 9: A e identifikoni dot gjuhën e urrejtjes



Grafiku 10: Cfarë do të bëni kur mund të identifikoni gjuhën e urrejtjes?



Një çështje ende kritike ngelet mungesa e informacionit, në rast se të rinjtë do të duan të raportojnë diskriminim apo gjuhën e urrejtjes. Ata nuk kanë shumë informacion se ku dhe si mund ta raportojnë atë.

Nga pyetësorët e realizuar, 90% prej tyre nuk dinë se ku ta raportojnë gjuhën e urrejtjes. I njëjti rezultat vjen dhe nga diskutimet me të rinjtë gjatë trajnimit. Ata që mendojnë se dinë ku ta raportojnë atë kanë përmenduar kryesisht median (televizionin) dhe policinë. Një numër i pakonsiderueshëm do e raportonin diskriminimin në institucionet që ligji parashikon dhe që merren në mënyrë direkte me këto çështje si Komisioneri Kundër Diskriminimit apo Avokati i Pupullit.

HISTORIT PERSONALE




Xhemal Kodragjini është një 18- vjeçarë, nga Titana, student i shkollës së mesme, i cili mori pjesë në trajnimin “Të luftojmë Stereotipet”. Ai ndan eksperiencën e tij personale në këtë trajnim.

Ky trajnim më ka bërë të ndiej një tronditje kulturore! Duke reflektuar kuptova që kisha paragjykitime dhe diskriminime kundra shumë njerëzve pa i menduar si të tilla. Tani që eci në rrugët e Tiranës, i respektoj njerëzit dhe u buzëqësh atyre dhe natyrisht nuk i paragjykojë më.

Nuk ua ngul sytë grupeve të caktuar njerëzish si romëve, LGBT apo njerëzve me aftësi të kufizuar. Mendoj që ata kanë vendin e tyre në këtë botë po ashtu si ne dhe kanë të drejtat e tyre të shprehin opininet në shoqëri / komunitet ashtu si çdokush tjetër. Gjatë trajnimit ne takuam dhe dëgjuam një anëtarë të komunitetit Romë (në Shqipëri), i cili ishte diplomuar në Universitetin e Oksfordit, një person me aftësi të kufizuar në një karrocë me rrota që ka luftuar dhe vazhdon të luftojë për të drejtat e komunitetit të vet dhe tre persona të rinj të grupit LGBT që jetojnë mes frikës dhe diskriminimit dhe mospranimit nga familja dhe shoqëria e tyre. Këto histori ishin shokuese për mua. Pasi i degjova të gjitha këto histori, fillova të mëndoja, -“unë nuk kam të drejtë t’i gjykojë këta njerëz”. Ata kishin kaq shumë eksperiencë në jetët e tyre sa që dinim më shumë sesa unë. Ishin mirënjohës në jetët e tyre dhe nuk i trajtonin komunitet e tjera ndryshe dhe e respektonin njëri- tjetrin. Historitë e tyre ishin shumë prekëse.

'Ky trajnim më ka prekur dhe më ka bërë të kuptojë se sa mendje ngushtë kam qënë më parë. Kjo eksperiencë më ka ndryshuar komplet në një person pozitiv'

Gjatë trajnimit unë kisha shumë argumente pothuajse në çdo diskutim. Kam shprehur mendimin tim për situata të ndryshme, si të reagosh kur shikon njerëz ndryshe nga ne dhe se si të luftosh stereotipet. Ndava eksperiencat e mia lidhur me temën, dhashë kontributin tim në organizimin dhe luajtjen e roleve, gjithashtu përgatita disa video për të vizualizuar kuptimin dhe përdorimin e krijimit të stereotipeve, diskriminimeve dhe gjuhës së urrejtjes. Ky trajnim më ka prekur dhe më ka bërë të kuptojë se sa mendje ngushtë kam qënë më parë. Kjo eksperiencë më ka ndryshuar komplet në një person pozitiv. Tani dhe në të ardhem premtoj që do të kujdesem për njerëzit me aftësi të kufizuar, Romëve, LGBT, fëmijëve me sindromën doun etj. gjatë gjithë jetës simë. Unë e kuptoj që vullnetarizëm nuk do të thotë që t’ju japësh para të tjerëve, por që t’ju falësh dashuri atyre...



Kristi Ndoj: Pjesmarrese ne trajnim . Reflektimii thyerjes së heshtjes për gjithë brezin e mendimit tim

Një nga problemet më paragykuese, më diskriminuese që më ka shoqëruar dhe që vazhdon të më shoqëroj akoma është pabarëzia gjinore. Shpesh here, më ka ndodhur t'a paragyktoj veten duke i dhënë mundësinë të tjerëve të më "shkelin" apo "shfrytëzojnë", por gjatë rritjes bota më mësoj që t'a kursej vetes këtë gjë. Përgjatë viteve, gratë kanë luftuar për pozicionin e tyre në shoqëri, për lirinë e për të drejtën e votës. Vetëm termi femër mbart me vete një mungesë evoluimi. Ndaj, të cilësosh si femër një grua, do të thotë ta përcaktosh atësi njëgjallesë, e jo si një qenie njerëzore.

Paragykimet në konceptimet dhe parashtrimet e materialeve gjinore gjenden dendur në tekste dhe leksione, duke ua pakësuar vlerat e tyre si instrumente të ndriçimit të mendjes dhe emancipimit të shpirtit të shoqërisë. Paragykimet dhe stereotipat më të rëndomtë të deformimeve gjinore janë ato ku gruaja identifikohet tërësisht ose kryesisht me funksionet riprodhuese. Të qënit nënë automatikisht i transferon asaj role përkujdesese përgjatë gjithëjetës. Injorimi i gruas në shumë fusha por edhe në tekste, mund të duket si gabim njerëzor, sjellja e stereotipave të jetës tradicionaliste në shkrime e publikime duket se është vepër e "fajtorëve pa faj". Nëse të rinjtë do të vazhdojnë të mos e ndjejnë se vëmendja ndaj edukimit gjinor, qytetar dhe demokratik nuk është një çështje preferenciale por detyrim, atëherë vajzat dhe gratë do të vijojnë të paraqiten qytetar të dorës së dytë.

Trajtimi i grave dhe vajzave si njerëz të tepërt dhe jo të barabartë ushqen totalitarizmin dhe përbën në vetvete një përpjekje totalitare. Gjithashtu, edukimi gjinor mbart edhe çështje të rëndësishme siç është ai i raportit mes burrit dhe gruas. Rëndom, këto raporte janë në favor të burrave. Kjo ushqen stereotipa, që prekin jo vetëm burrat dhe gratë, por

Trajtimi i grave dhe vajzave si njerëz të tepërt dhe jo të barabartë ushqen totalitarizmin dhe përbën në vetvete një përpjekje totalitare.

edhe shumë aspekte të tjera të shoqërisë, përfshirë arsimin, praktikat e edukimit formal dhe joformal të brezit të ri. Autorët e teksteve, akademikët e pedagogët duhet të kenë parasysh dhe duhet të kujdesen që në temat që trajtojnë figurat femërore dhe mashkullore duhet të tejçojnë një ideologji të drejtë mbi rolet të drejtat sociale. Askujt nuk duhet t'i atribuohen apriori detyra dhe pritshmëri pikërisht pse është mashkull apo femër, burra apo grua, djalë apo vajzë. Duhet të trasmetohen tek studentët ideologji që formojnë më mirë qytetarin dhe shtetasin e së ardhmes. Shoqëria, sidomos ajo shqiptare, e përcepton gruan në role të paracaktuara brënda familjes. Portretizimi i djemve dhe vajzave duke u rritur dhe emancipuar së bashku është pozitiviteti që duhet të sjellin tekste.

Edukimi gjinor, ndryshe nga shumë aspekte të tjera të edukimit, nuk ka një standard të paracaktuar dhe nuk matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, siç mund të maten datat, listat, kategoritë apo vendet. Pikërisht, prej këtij fakti, edukimi gjinor bëhet një angazhim i veçantë. Ai nuk është edukim feminist e moralizues, por një ftesë që çdo student të ketë shans të mësojë të sillet në përputhje me identitetin e tij gjinor.

Jetojmë në një kohë kur të gjithë përballemi me komunikimin. Heshtja është heshtje. Si e tillë ajo duhet thyer. Prapa thyerjes së heshtjes bien lëvozhgat e pagjykimet, diskriminimit të kalbur gjinor dhe shpërthejnë energjitë e reja. Thyerja e heshtjes është prologu i gjithçkaje. Thyerja e heshtjes lypet të shpojë turmat që nuk dinë të dëgjojnë. Në vend të heshtjes, koha kërkon komunikim, komunikime në nivele të ndryshme, nga lokalet te globalet, nga interaktivet te virtualet. Komunikimi është bërë forma tipike e ekzistencës dhe funksionimit të rendit të sotëm. Përmes komunikimit të hapur, interaktiv mund të parashtrijmë vizione të barabarta dhe barazi për të gjithë. Ishte pikërisht komunikimi i hapur dhe bashkëveprimi me të tjerët ajo çfarë e bëri më produktive dhe më cilësore trajnimin "Lufta kundër Steriotipeve; Urrejtja shpërndahe nëse nuk flet".

Xhenis Dema. Pjesmarrese ne trajnim

Trajnimi "Lufta kundër stereotipeve, urrejtja shpërndahet në rast se nuk flet" më la mbresa shumë positive. Duke qënë trajnimi i parë që merrja pjesë, pritshmëritë e mia qëndronin larg mënyrës sesi ishin konceptuar ditët e trajnimit. Prisja që çdo gjë të qëndronte në planin teorik, me trajnues që referojnë përballë grupit të interesuar të pjesëmarrësve në lidhje me temën.

Fillimisht, mendova se koha për përfshirjen e pjesëmarrësve në trajnim, do të ishte shumë e limituar, duke qënë se në fillim të gjithë u njohëm me një plan të detajuar të ditëve dhe koha në dispozicion për çdo seksion të trajnimit ishte e mirëpërcaktuar dhe e llogaritur.

Megjithatë, përgjatë çdo seksioni të veçantë çdokush prej nesh u ndje i lirë të shprehte mendime dhe sugjerime, herë-herë edhe subjektive në lidhje me temën. Të ishte pjesë e një grupi të rinjsh të moshave të ndryshme, me këndvështrime dhe formime të ndryshme fillimisht më krijoi përshtypjen e një grupi heterogjen, në të cilin do të ishte e vështirë të gjendej gjuha e përbashkët. Megjithatë, nëpërmjet një "kushtetute" të pranuar unanimisht, arritëm të flisnim dhe të dëgjonim çdokënd, duke respektuar mendimin e njëri-tjetrit dhe duke shkëmbyer ide dhe mendime të ndryshme.

E veçanta e trajnimit mendoj se qëndronte pikërisht tek fakti që stafi krijoi një atmosferë, në të cilën çdo pjesëmarrës u ndje i lirë për të shfaqur veten pa u ndjerë i paragjykuar për idetë dhe konceptet. Mënyra e transmetimit të informacionit e ndërthurur me lojën, krijuan një ambient interesant në të cilin kurioziteti për atë çka do të vinte më vonë shtohet dita-ditës dhe bashkë me të dëshira për të qënë pjesë aktive e diskutimit në kuadër të një marrëdhënie në nivelin e shkëmbimit të ideve dhe eksperiencave.

Pjesë shumë e rëndësishme ishte njohja nga afër me historitë personale të njerëzve që stereotipizohen rëndom në shoqëri. Të njihje nga afër historitë e tyre mendoj se zgjoi empatinë e të gjithë pjesëmarrësve dhe nga që ajo ditë brenda vetes ndjeva nevojën për të dhënë kontribut më konkret për këdo që ka nevojë, gjë që shpesh nuk e gjen në shoqërinë individualiste ku jetojmë.

Në përmbyllje të ditëve të trajnimit, të cilat kaluan shumë shpejt, përveç njohjes me miq të mirë, ndjej se përfitova shumë më tepër në aspektin personal. Ndjem njeri më i mirë dhe besimplotë. Unë besoj se një ditë konceptet e vjetëruara në Shqipëri do të jenë pjesë e historisë së shkuar. E ndjej të nevojshme të shpreh falenderime të sinqerta për stafin e PVN, për mënyrën e organizimit, respektit që treguan për çdo pjesëmarrës, duke u kujdesur edhe për detajet më të vogla në mënyrë që të gjithë ne si pjesëmarrës përveçse të merrnim diçka nga trajnimi, të ndjeheshim të lirë për të shprehur dhe për të shfaqur anët tona, të cilat ndoshta në përditshmëri vështirë se do i ndanim pa frikën e paragjykimeve.

Shpresoj shumë që të rinj të tjerë të bëhen pjesë e këtij trajnimi, të ndjehen të lirë të përfshihen në tematika të tilla dhe të njohin njëri-tjetrin pa u përpjekur të gjykojnë jetën dhe këndvështrimet e askujt.



'Nëpërmjet një 'kushtetute' të pranuar unanimisht, arritëm të flisnim dhe të dëgjonim çdokënd, duke respektuar mendimin e njëri-tjetrit dhe duke shkëmbyer ide dhe mendime të ndryshme.'

SOKOL MURATAJ - JETA IME PAS AKSIDENTIT AUTOMOBILISTIK: "Libri" – Librari Njerezore



Unë jam Sokol Murataj, baba i dy fëmijëve. Kisha një jetë normale si gjithë të tjerët derisa ajo më ndryshoi njëherë e përgjithmonë. Në vitin 1997 pësova një aksident automobilistik, i cili shënoi vazhdimësinë time. Ishte një aksident shumë i vështirë dhe për disa ditë qëndrova në koma. Për dy muaj reshtë, mjekët nuk arrinin dot që të thoshin nëse do të jetoja ose jo.

Megjithatë u kapa fort pas kujtimit të familjes time e mbi të gjitha pas arsyes pse unë isha bërë një njeri më i mirë, djalit tim të madh. Doja të jetoja vetëm që ta shikoja atë të rritej. Ta çoja në shkollë, t'i jepja puthjen e natën-e-mirës, ta ledhatoja e të përqafoja fortë, por kur hapa sytë realiteti ishte krejt ndryshe. Duket një moment si skenar filmash. Kur hapa sytë shikoj babin aty tek koka që po qante nga gëzimi dhe të gjithë erdhën me pas dhe u lumturuan jashtëzakonisht shumë. Por unë e kuptova menjëherë se diçka nuk shkonte. Nuk mundja të lëvizja dot. Nuk po e komandoja dot trupin tim. Erdhi doktori më vonë dhe aty kam marrë lajmin më të tmerrshëm, isha paralizuar për gjithë jetën. Babai ra në dëshpërim të plotë, ndërsa gruaja ime filloi të largohej prej meje. Kam ndenjur 1 vit në spital dhe në krye të vitit babai im ndërroi jetë. Kalova një traumë shumë të madhe. Gruaja u largua prej meje ndërsa babai më vdiq. Të gjithë pyesin se si e kalova, por unë munda. Duhet të luftoja për jetën time, ishte akoma shumë shpejt për tu dorëzuar. Dhe fitova. Fitoi jeta.

'ISHTE NJË AKSIDENT SHUMË I VËSHITRË DHE PËR DISA DITË QENDROVA NË KOMA, PËR DY MUAJ RESHTË, MJEKËT NUK ARRININ DOT QË TË THOSHIN NESE DO TË JETOJA OSE JO.'

Në fillim e kisha shumë të vështirë që të përshtatesha me atë çfarë unë isha bërë, me përkujdesjet që duhet të kisha dhe me terapitë që duhet të bëja. Në vitin 1999 i dhashë forcë vetes dhe vendosa të vazhdoj duke krijuar Shoqatën e Paraplegjikëve në Fier, duke ndihmuar aty të gjithë ata që kishin të njëjtin problem. Ndiheh shumë më mirë kur e di që është dikush që e kupton atë që ti ndien dhe për këtë arsye kjo Shoqatë sa erdhi e u zgjerua shumë, derisa në muajin Qershor të vitit 2000, mbas një proteste para Kryeministrisë dhe një greve urie arritëm të bënim ndryshimin në ligj dhe të merrnim statusin si Paraplegjik në Qershor të viti 2000. Po të mos luftonim nuk do e merrnim.

Në vitin 2001 largohem nga Shqipëria në drejtim të Danimarkës, duke kërkuar azil politik dhe humanitar nga shteti danez. Mjeku i kampit ku unë rrija i vuri re problemet e mia dhe më dërgoi menjëherë në një Qendër Rehabilitimi për Dëmtimet e Shtyllës Kurrizore". Aty jam trajtuar për 2 vite me radhë me trajtime që bëheshin të plota tre muaj në vit. Aty kërkova njohje ndërkombëtare të problemeve për Personat me Aftësi të Kufizuar, Para dhe Tetraplegjikë dhe hartuam se bashku me Shoqatën Daneze të Paraplegjikëve Ryk.dk dhe ISCoS.org.uk një projekt për një Qendër Rehabilitimi të tillë edhe në Shqipëri.

Në Maj të viti 2003 njoftohem që shteti danez ma kishte refuzuar kërkesën për azil politik dhe humanitar. Pas përpjekjesh të mëdha dhe lobimit me OJF-të mbështetëse daneze ku ia

arrita qëllimit dhe fitova besimin e ISCoS.org.uk, duke u përfshirë në një projekt ambicioz, më duhet të kthehesha në Shqipëri. U ktheva në Tiranë në Janar të viti 2004 dhe u mundova me mish e me shpirt që projektet e mia të ecnin përpara. Menjëherë fillova aktivizimin tim në shoqata të ndryshme, ku puna nuk shkonte aq mirë, por ja dola!

Si aktivist i paepur, pas shumë vitesh punë me mbështetjen e ISCoS arrita të organizoja në 31 Maj 2014 Seminarin e suksesshëm, më tej me mbështetjen e Escif.org projektova Shoqatën. Aktualisht jam President i "Shoqata e Personave me Dëmtime të Shtyllës Kurrizore të Shqipërisë" (SHPDSHKSH) dhe jam munduar me aq sa kam pasur mundësi, që të ndihmoj personat të cilët kanë qenë në vështirësi. Kur ndodhën përmbytjet në jug kam vënë në dispozicion mjetin tim për të çuar ushqimet dhe kam shkuar edhe vetë për t'i ndihmuar. Në atë kohë madje e kanë bërë bujë edhe mediat gjestit tim, por unë nuk e kam bërë për këtë gjë. E ndjeva dhe e bëra. Njeriu duhet të jetë solidar. Sot vazhdoj të ndihmoj me sa mundem të gjithë ata që kanë nevojë, por i vetëm nuk mund t'ia dal. Unë kam nevojat e mia, kam pamundësitë e mia edhe pse përpiqem që gjithnjë ti mund ata që munden. Ndaj vendosa të bëj një apel të ju për të gjithë ata që mund të na ndihmojnë ne si shtresë. Të na japin një dorë që ne të mundim t'i japim një mbështetje nëpërmjet kontributit tuaj me kohë, përkushtim, angazhim, vullnetarizëm ndaj kësaj kategorie të shoqërisë (personave me aftësi të kufizuar). Ata janë aty dhe unë po i thërras.

'PËR TË RINJË KAM NJË MESAZH TË QARTË, NDIQNI ENDRRËN TUAJ DHE ASNJËHERË MOS U DORËZONI PËR VËSHTIRËSIVË QË KA JETA, JETONI GJITHMONË TANI MOMENTIN DHE FITONI PËRVOJA NGA JETA PA PASUR FRIKË TË BËNI GJËRA.'

Në Mars të vitit 2006, pasi kisha kaluar një kalvar vështirësish dhe fitoresh, kisha marrë trajtimin e duhur shëndetësor dhe emocional, ndihesha më mirë fizikisht, më i qetë dhe në gjendje të kujdesesha për vete dhe të tjerët. Atëherë vendosa të kërkoja atë pjesë timen që mu mohua për vite me radhë, atë dashuri që më bëri të zgjohesha nga koma me dëshirën, se do rrisja më shumë përkujdesje, por që m'u mohua.

Vendosa ta kërkoj djalin tim nëpërmjet emisionit "Me Zemër të Hapur". Doja ta njihja, të ofroja dashurin time, të përmbushja detyrimet e një babai për mirërritjen e tij. E gjeta, i fola me shumë emocione. Gjatë daljeve të mia në TV, ndër shumë teleshikues, më kishte ndjekur dhe një vajzë, e cila kishte kërkuar kontaktet e mia në redaksi. I kishte bërë përshtypje historia ime, karakteri, dhe kërkoi që të takoheshim, nuk mendoja se aty do të gjeja dashurinë e jetës time, Mimozën, dhe lidhim jetën, martohemi dhe kemi një djalë 8 vjeç.

Gjatë gjithë jetës, ka momente që të neglizhojnë, përjashtojnë, diskriminojnë, ka njerëz që të trajtojnë me mëshirë, dhembshuri, dashuri. Ajo që të gjithë kemi nevojë pavarësisht se kush jemi dhe çfarë grupi i përkasim është vetëm dashuria. Unë kam mundur të kaloj vështirësitë duke iu dal përballë problemeve me dashuri, duke i njohur problemet, duke i pranuar dhe kështu është më e lehtë të punosh me to. Në këtë mënyrë përqendrohesha tek zgjidhja dhe se sa mirë ndihesha pasi ia dilja, ky është i menduari pozitiv.

Për të rinjtë kam një mesazh të qartë, ndiqni ëndrrën tuaj dhe asnjëherë mos u dorëzoni para vështirësive që ka jeta, jetoni gjithmonë tani momentin dhe fitoni përvoja nga jeta pa pasur frikë të bëni gjëra.

KAPITULLI 3: MËNYRAT E REDUKTIMIT

“NËSE NUK TË PËLQEN DICKA,
NDRYSHOJE. NËSE NUK MUNDËSH TË
SJELLESH NDRYSHIM, NDRYSHO
QËNDRIMIN TËND.” **MAYA ANGELOU**



Ky kapitull synon të tregojë se si individët mund të punojnë sëbashku për të luftuar përhapjen e stereotipave negativ dhe për të mposhtur përfundimisht paragjykimin dhe diskriminimin në shoqërinë tonë.

Është totalisht e mundur të mposhten paragjykimet, duke u lidhur me të tjerët, duke dëgjuar nevojat e atyre që vijnë nga etni të tjera, raca të tjera, orjentime të tjera seksuale, etj. Ne do të donim të sfidonim idenë se pikëpamjet e njerëzve janë të gdhendura në gur, do të donim të fuqizonim të rinjtë, edukatorët, punonjësit e rinj dhe ti bënim ata të hapnin mendjen e tyre ndaj diversitetit. Shpresojmë se informacioni që ju vendosim në dispozicion të jetë sadopak orjentues. Kini parasysh që çdo preson ka fuqinë të ndryshojë botën e tij dhe të jetë një model udhërrëfyes për të tjerët.

Individet shpesh tremben nga ajo që nuk dijnë. Mbrojtja më e mirë ndaj stereotipave është dija. Edukimi dhe

familjarizimi me objektin e paragjykimit apo stereotipit e lejon të vërtetën të zbulohet dhe të zbatohet (Foëers & Richardson, 1996; Rudman, Ashmore, & Gary, 2001). Edukimi i jep individit aftësinë të përqafojë dhe të pranojë ndryshimet tek të tjerët dhe ndihmon në kohezionin social (Plant & Devine, 2009). Armatosja e individit me njohuri dhe informacion lehtëson barrë e paditurisë. Zotërimi i të vërtetës na mbron ndaj paragjykimeve, stereotipave dhe diskriminimeve (Plant & Devine, 2009). Një mënyrë sesi një person mund të mposhtë stereotipin është duke shpenzuar kohë me personin të cilin ai apo ajo e ka subjekt të stereotipit (Foëers & Richardson, 1996; Tausch & Heestone, 2010). Shpenzimi i kohës sëbashku i lejon të dy grupet, të fillojnë të kuptojnë dhe të njohin njeri-tjetrin në një nivel më personal. Një gjë e tillë i nxit personat që të mos besojnë më në stereotipa nëse shohin së stereotipi është dicka e rremë (Foëers & Richardson).

VULLNETARIZMI

Shpesh në ngecim brenda filluskës sonë. Shkojmë në shkollë, në punë, në shtëpi, në aktivitete, në darka me shoqërinë, etj. Nuk gjejmë kohë për të dalë e për të parë se çfarë ndodh në të vërtetë përreth nesh. Një mënyrë për ta bërë këtë është vullnetarizmi. Vullnetarizmi është një aktivitet me përfitime të shumanshme. Së pari, ofrohet mundësia e njohjes me vullnetarë të tjerë që ndajnë të njëjtin pasion për të ndihmuar. Së dyti, do të keni mundësinë të ndërveproni me personat që po ndihmoni, duke ju bërë të kuptoni se edhe ata janë njerëz si ju me pasionet dhe dëshirat e tyre.

ZGJERO BOTËN TËNDE



UDHËTIMET

Dil jashtë kufijve të vendit tënd. Nuk po nënkuptojmë udhëtimet në resortet ku përfshihet gjithçka. Shko dhe përjeto një kulturë tjetër, tako njerëz të rinj dhe shiko sesi është jeta gjatë. Nuk ka asgjë më frymëzuese sesa ballafaqimi me një kulturë krejt të re e të huaj.

BËNI MIQ

Është vërtet me vlerë. Mund të jetë më e vështirë nga sa duket po është një veprim që do të ketë një ndikim të pamasë në këndështrimin tuaj për jetën. Kjo jo për faktin e të bërit shokë, por për atë çka mëson mbi diferencat kulturore, që ju mund ti keni marrë kurrë parasysh por që për të tjera kanë qenë sfida jetësore.

DËGJONI

Një nga aftësitë më të rëndësishme në jetë, të dëgjuarit, është gjithashtu kritike në njohjen dhe dallimin e paragjykimeve tona. Fjalët kanë peshë prandaj përdorini me kujdes kur përshkruani njerëzit, miqtë apo familjarët tuaj. Kjo kërkon një përpjekje të vetëdijshme dhe heqjen dorë nga ideja që ka ndërmend për të thënë. Respektoni njerëzit me të cilët ndërveproni pavarësisht se çfarë besoni apo dini rreth tyre.

A young girl with dark hair, wearing a blue winter jacket with white polka dots and a white hat with a colorful pattern, is holding up a white sign with the words "LOVE not hate" written on it. The sign has "LOVE" in large red letters and "not hate" in blue and red lowercase letters. She is looking off to the side with a serious expression. The background shows a multi-story brick building with many windows, some of which are lit up, suggesting an urban setting during the day or early evening.

LOVE
not hate

LIDHJET NJERZORE

Sipas filozofit Levinas (1969), mënyra për të mposhtur tendencën tonë për të "tjetërsuar" është nëpërmjet një takimi kokë më kokë me "tjetërin". Një lidhje njerëzore është një nga mënyrat konkrete për të tejkaluar pikëpamjet tona negative për "tjetërin". Kështu, në vend të një ideje abstrakte për të cilët po "tjetërsojmë", ne vendosim një lidhje personale. Nëse dëshirojmë të luftojmë paragjykimin në mënyrë të efektëshme, duhet të inkurajojmë dhe ndihmojmë dialogun midis njerëzve me formime dhe prejardhje të ndryshme.

Një mënyrë për të venduar një dialog të tillë është nëpërmjet Librarisë Njerëzore. Libraria Njerëzore është një takim ku njerëz nga grupe të ndryshme minoritare ftohen për të ndarë përvojat e tyre personale dhe sfidat që ju vijnë si pasojë e të qenit pjesë e një minoriteti. Shëmbuj të minoriteteve të ndryshme përfshijnë njerëzit me aftësi të

kufizuara, ashtu si edhe LGBT apo ata me prejardhje të ndryshme fetare apo etnike si mysliman apo romë. Duke iu dhënë minoriteteve një hapësirë të tillë të sigurt nga ku mund ti drejtohen një shoqërie më të gjerë, ne ndhmojmë në luftë kundër paragjytimeve dhe urrejtjes kundrejt "tjetërit", duke i dhënë komuniteteve më të vogla një fytyrë njerëzore, me të cilën të tjerët mund të lidhen në një nivel personal, sic pohon edhe Levinas.

Në mënyra si kjo, ne dalëngadalë ndryshojmë perceptimin e shoqërisë për minoritetet dhe inkurajojmë njerëzit të hapin mendjen e tyre drejt njeri-tjetrit dhe të shohin ngjashmëritë që i bashkojnë dhe jo ndryshimet që i ndajnë. Kështu, njerëzit do të vlerësojnë shoqëritë që ata do të krijojnë me ata të cilët dikur i shihnin si "të tjerë" dhe paragjykimet e vjetra do të veniten.

ROLI I INSTITUCIONEVE KOMPETENTE,

SIGURIMI I INFORMACION

Siguroni sa më shumë informacion për stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimin dhe shpërndajeni atë, kryesisht midis të rinjve. Nga të dhënat e mbledhura nga pjesëmarrësit në lidhje me trajnimin, rreth 85% e të rinjve (nga 235 përgjigje) nuk mund të bënin ndarjen midis stereotipeve, paragjykimeve dhe diskriminimeve. E njëjta përqindje është edhe për përkufizimin e këtyre koncepteve. Shumica e të rinjve shpesh nuk e kuptojnë kur diskriminojnë apo kur diksriminohen. Situata bëhet akoma më e komplikuar nëse marim në shqyrtim grupmoshat e tjera (p.sh. moshën e mesme). Institucionet e edukimit dhe media kanë rolin primar në rritjen e sasisë së informacionit.

PROMOVONI SHEMBUJT POZITIVË DHE ARRITJET PERSONALE

Nga ndonjëherë përvojat reale ndikojnë sjelljen e atyre që diskriminojnë apo që diskriminohen. Diskriminuesit ndërgjegjësohen më tepër pasi dëgjojnë histori personale, kuptojnë ndjenjat e tyre dhe lëndimin që kanë shkaktuar. Përgjithësisht ata nuk mendojnë për pasojat, për ndjenjat apo humanizmin por diskriminojnë sepse kanë krijuar perceptimet dhe besimet e tyre pavarësisht realitetit.

Promovimi i historive personale apo shembujve pozitivë se si diskriminimi është mposhtur apo tejkaluar mund të inkurajojë të tjerë njerëz që të përjetojnë situata të ngjashme.

KRIJONI MEKANIZMA TË AKSESUESHËM KU NJERËZIT MUND TË RAPORTOJNË DISKRIMINIMIN.

Nëse individët informohen se çfarë është diskriminimi, krijojnë besim tek mekanizmat e raportimit të diskriminimit dhe ndërgjegjësohen për atë çka duhet të bëjnë, atëherë ata do të jenë të gatshëm të raportojnë çdo lloj dikriminimi që përjetojnë apo dëshmojnë. Në shqipëri ekziston Institucioni i Komisionerit Kundër Diskriminimit, i cili zhvillon një punë profesionale për këtë çështje. Megjithatë qytetarët duhet të jenë më të informuar mbi punën e tij dhe procedurat që duhet të ndjekin.

VENDOSNI DHE MBANI NJË BASHKËPUNIM TË FORTË

Bashkëpunimi midis grupeve të ndryshme të interesit të tilla si institucionet qeveritare, sektori privat, organizata, media, anëtarë të komunitetit, shkolla, universitete promovojnë diversitetin dhe përfshirjen sociale. Secili prej këtyre aktorëve mund të kontribuojë i vetëm ose në grup në përhapjen e përvojave, raportimeve, referencave, mbështetjes, respektimit të ligjit dhe shpërndarjen e informacionit.



SIGURONI TRAJNIME DHE AKTIVITETE MOBILIZUESE

Është detyra e aktorëve të ndryshëm për të siguruar mundësi konkrete për të rinjtë në rritjen e nivelit të informacionit dhe kapaciteteve në reduktimin e diskriminimit. Përshembull shkollat dhe universitetet mund të bashkëpunojnë me organizata të ndryshme për të organizuar trajnime, për të ftuar përfaqësues të kategorive të ndryshme në përhapjen e përvojave. Organizatat që punojnë me kategoritë në nevojë, që vijnë nga etni të ndryshme, mund të përfshijnë më tepër të rinjë në aktivitete vullnetare dhe të reduktojnë kështu në mënyrë konstante diskriminimin. Nëse u flasim të rinjve për vullnetarizmin, aktorët kompetentë duhet të t'u sigurojnë atyre informacion të mjaftueshëm për mundësitë e vullnetarizmit.

Në vijim ka plot projekte mobilizimi, për shembull trajnime në Shqipëri dhe jashtë të mundësuar nga Këshilli i Europës, Erasmus +, etj, si një mundësi mjaft e madhe për të rinjtë për të udhëtuar dhe për të rritur kapacitetet e tyre.

IMPLEMENTO KORNIZËN LIGJORE DHE EDUKIMIN CIVIL

Siç citohet në kapitullin e parë, ka mjaft mekanizma ligjorë, për të reduktuar, raportuar dhe luftuar diskriminimin. Sipas të dhënave të mbledhura dhe perceptimeve nga trajnimi, institucionet qeveritare duhet të krijojë mekanizma konkret për të zbatuar ligjin. Njerëzit duhet të informohen dhe të kuptojnë parashikimet e ligjit ashtu si edhe të ndryshojnë perceptimin dhe besimin për rolin e institucioneve ligjzbatuese. Për të arritur këtë ndryshim ne si individë duhet të rrisim kërkesat tona dhe institucioneve kompetente ndërkohë që këto institucione duhet t'iu përgjigjen detyrave të tyre në mënyrë korrekte.





LUFTA KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES DHE LORI I TË RINJVE DHE EDUKATORËVE

Zgjidhet kundër gjuhës së urrejtjes fillojnë me të kuptuarit e përgjegjësive personale duke evituar të qenit personi që nis dhe përhap gjuhën e urrejtjes, ashtu si kurse të kuptuarit e fuqisë për t'iu përgjigjur gjuhës së urrejtjes dhe për të mbështetur personin e shënjestruar. Shpesh ajo çka nis dhe perceptohet si një shaka pa qëllim për të lënduar ndokënd, mund të kthehet në një situatë që lëndon. Për shumë raste një kundër argument i thjeshtë mund ta ndryshojë situatën duke e bërë personin që të kuptojë dëmin që shprehitet e tij shkaktajnë madje dhe të mbështesë personin e shënjestruar, i cili do të kuptojë që nuk është i vetëm. Edukimi që në moshë të re i ideve dhe respektit për diversitetin si dhe promovimi i vlerave të barazisë dhe komunikimit jo të dhunshëm, është një gur themeli në luftën ndaj gjuhës së urrejtjes dhe sjelljeve diskriminuese. Mësuesit dhe edukatorët joformal luajnë një rol thelbësor në këtë proces. Ata sfidojnë stigmat sociale, kontribuojnë në formimin e vlerave të orientuara drejt të ardhmes ashtu si dhe modelimin e sjelljes së fëmijëve dhe të rinjve. Këto vlera janë të bazuara në parimet e barazisë dhe respektin për diversitetin. Në mënyrë që kjo të ndodh, është shumë e rëndësishme të sigurohet që vetë mësuesit dhe edukatorët janë të ndërgjegjshëm për format e gjuhës së urrejtjes, dëmin që ajo shkakton si dhe të kenë kapacitetin për ta identifikuar atë në klasë/ grup dhe t'i përgjigjen asaj në një mënyrë të përshtatshme dhe konstruktive. Krahasuar me rolin e prindërve dhe familjes, mësuesi apo edukatori ka

mundësinë të vëzhgojë dinamikën e grupit dhe lidhjen midis studentëve të ndryshëm. Ata mundet gjithashtu të monitorojnë qëndrimet e tyre ndaj përfaqësuesve të grupeve minoritare. Prandaj, është në dorën e mësuesit/ edukatorit për të mbajtur një ambient tolerant dhe gjithëpërfshirës në klasë, për të zhvilluar respektin për diversitetin dhe për të ndërgjegjësuar nxënësit mbi ndikimin e mundshëm të sjelljes së tyre kundrejt përfaqësuesve të grupeve vulnerabël. Të rinjtë kanë një potencial dhe përgjegjësi të madhe kur bëhet fjalë për parandalimin e gjuhës së urrejtjes në një mjedis të përbashkët. Megjithatë roli i tyre bëhet edhe më i rëndësishëm kur bëhet fjalë për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit online. Të rinjtë janë "të lindur online" dhe shpenzojnë një kohë të konsiderueshme online dhe kryesisht në mediat e ndryshme sociale. Sipas statistikave të Këshillit të Europës mbi 80 % e të rinjve janë dëshmitarë të gjuhës së urrejtjes online dhe 1/3 e tyre kanë qënë subjekt i saj të paktën një herë nëpërmjet komenteve urryese online dhe offline. Duke qënë se të rinjtë janë më të ekspozuarit ndaj gjuhës së urrejtjes online, reagimi i tyre është shpesh ai që bën diferencën, sidomos kur bëhet fjalë për komunikimin një me një. Gjithkush mund të bëhet objekt i gjuhës së urrejtjes. Secili nga ne ka përgjegjësinë të reagojë, qoftë individualisht apo nëpërmjet ngritjes së një reagimi në komunitet duke u bashkuar me me shokët, kolegët etj.

RAPORTIMI I GJUHËS SË URREJTJES

'BOTA NUK SHKATËRROHET NGA DUAN TA SHKATËRROJNË ATË, POR NGA ATA QË NUK BEJNË ASGJË PER T'I NDALUAR ATA.'

ALBERT EINSTEIN


Disa shtete e konsiderojnë gjuhën e urrejtjes si një shkelje administrative ose edhe penale, duke e bërë të mundur raportimin e saj drejtëpërdrejtë tek autoritetet. Megjithatë në shumë shtete të tjera kjo është ende e pamundur. Egzistojnë disa hapa të thjeshtë që mund t'ju ndihmojnë të kuptoni si dhe kur është më e përshtatshme ta raportoni gjuhën e urrejtjes.

Nëse vëreni gjuhën e urrejtjes dhe sjellje të ngjashme në klasën apo grupin tuaj në varësi të situatës ju duhet të përqipeni të flisni me fyesin dhe viktimën e gjuhës së urrejtjes, ashtu sikurse edhe me shokët e klasës, ndërhyrja e të cilëve mund të ndihmojë në zgjidhjen e situatës. Nëse ajo vazhdon, raportojeni rastin tek mësuesi dhe tek prindërit. Në disa raste, kryesisht kur viktimia i përket një grupi të marxhinalizuar ju mund të kontaktoni OJQ-në që punon me atë grup të caktuar dhe që mund të sigurojë mbështetje të specializuar. Ju mund të raportoni për shprehjet e urrejtjes edhe në mediat sociale nëpërmjet instrumentave të brendshëm raportues, të cilët janë specifik

për secilin rrjet. Kjo nuk ndosh me webside private, forumet online, etj. Nëse ju hasni gjuhën e urrejtjes online (pavarësisht nëse e gjeni në mediat sociale apo website private) mund ta raportoni tek Vëzhguesi i Gjuhës së Urrejtjes (Hate Speech Watch) në platformën e lëvizjes Jo Gjuhës së Urrejtjes (www.nohatespeechmovement.org) duke plotësuar një formular online. Vëzhguesi i Gjuhës së Urrejtjes është një mjet i cili shërben për të rritur ndërgjegjësimin rreth përhapjes formës dhe shënjestrës së gjuhës së urrejtjes nëpër Europë, gjithashtu për të identifikuar çështjet më të ngutshme dhe për të zhvilluar veprime të koordinuara në komunitet. Është e rëndësishme të kuptohet që vëzhguesi i gjuhës së urrejtjes nuk është një mjet çensurimi por shënjestron gjuhën e urrejtjes pa zvogëluar lirinë e shprehjes. f

SHEMBULL:

Nuk ka rëndësi se ku ndeshesh me gjuhën e urrejtjes. Mos qëndro indiferent por reago në mënyrën e duhur, natyrisht pa vënë në rrezik sigurinë personale. Mos u bëj spektator. Secili nga ne mund të bëj diferencën.



KAPITULLI 4: **AKTIVITET**

**“REZULTATI MË I LARTË I EDUKIMIT
ËSHTË TOLERANCA ” HELEN KELLER**

AKTIVITETE KONKRETE DHE ISHTRIME



Ky kapitull prezanton për punonjësit e rinj dhe edukatorët, aktivitete konkrete të tilla si nxemje, punë në grup, lojra dhe ushtrime reflektimi. Secili aktivitet mund të përshtatet sipas nevojave të grupit me të cilin do të punoni, duke marrë parasysh madhësinë e grupit, kontekstin dhe hapësirën që keni në dispozicion. Shpresojmë t'i përdorni këto burime për t'iu qasur temave të ndjeshme të tilla si paragjykimi, diskriminimi, dhe gjuha e urrejtjes tek të rinjtë, në mënyrë që të jenë të qarta, interesante dhe të nxisin diskutim.

UDHËRRËFYES PËR TRAJNIME

Organizoni trajnimin në grupe me 2-3 persona. Sigurohuni që ndihmësit të jenë femra dhe meshkuj. Kjo është e nevojshme për të siguruar një balancë dhe perspektivë gjinore gjatë diskutimit të temave.

Jini të përgatitur. Para se të filloni, sigurohuni që skuadra juaj të jetë e mirëinformuar se çfarë janë duke bërë.

Kontrolloni planin mësimor së bashku dhe vendosni rolet përkatës për secilin ndihmës.

Jini të sjellshëm, tolerant dhe të respektueshëm. Tregoni respekt në komunikim me pjesëmarrësit dhe njëri-tjetrin. Kur të jeni duke zhvilluar trajnime për tema sensitive, disa njerëz herë pas here mund të shprehin komente jokorrekte dhe ofenduese. Në vend që t'i kundërviheni drejtëpërdrejtë, gjeni një mënyrë për ta zbutur diskutimin dhe sigurohuni të flisni privatisht me këta studentë nëse është e mundur.

Jini të ndjeshëm. Sigurohuni nëse ka pjestarë të grupeve minoritare, viktimë të diskriminuar apo nëse përdoret gjuha e urrejtjes.

Kurrë mos i detyroni pjesëmarrësit të flasin nëse nuk ndihen konfident për një temë të caktuar.

Sigurohuni t'i trajtoni me barazi të gjithë pjesëmarrësit. Organizojeni trajnimin në mënyrë miqësorë dhe argëtuese!

AKTIVITETI: MOLEKULAT E NJEJTA

Tema: Të reflektojmë në identitetin personal dhe të njohim paragjykimet personale

Materialet: Fleta, stilolapsa

Koha: 40/45

PREZANTIMI:

Le të thellohemi më shumë në temën e identitetit nga pikëpamja e vetëpërshkrimit. Cilat aspekte janë të rëndësishme për ne? Jeni të ftuar për të studiuar identitetin kulturor, social dhe personal tuajin!

Ideja është që të vizatoni një molekulë të identiteteve tuaja. Ne të gjithë kemi aspekte të shumta të identitetit, kështu që përpiquni të mendoni për ato që janë më të rëndësishme për ju tani. Jepni shembullin tuaj në tabelë: vëllezër, turq të racës së bardhë, migrant, freelancer, vegan, etj...

Krijoi 5 grupe sociale, me të cilët e identifikoni veten në këto momente, të cilët krijojnë identitetin tuaj. Shmangni

veçori, mbiemra, fjalë që lidhen me pamjen; shënioni pesë emra në pesë rrrathë.

Shënim: Jepini secilit pjesëtar një fletë letre për të vizatuar një rreth në mes (emrin e tij/saj) dhe pesë të tjerë përreth, të cilët janë grupet me të cilët ai/ajo identifikohet.

Zbatimi: (punë individuale + grupe të vogla + pozicionim)

Pyetjet për grupet e vogla:

Pse janë këto grupe të rëndësishme për ju?

A ishte e thjeshtë të zgjidhnit?

Cilat eksperiencia positive / negative keni patur, në lidhje me këto grupe sociale?

Në fund çdo person zgjedh për veten e vetë një ose dy grupe, të cilat janë burime primare të identitetit, ndoshta edhe të grupit! (shkruajini ato në fushat e modelimit të debatit).

LOJRAT ENERGIJE (ENERGIZERS):

Lojrat energjike janë lojra të shkurtëra që i ndihmon pjestarët të jenë më aktiv. Para ose pas një aktiviteti është e këshillueshme një lojë e tillë. Për të mësuar më shumë mbi lojrat energjike vizitoni web-faqen SaltoYouth në seksionin e aktiviteteve energjike. Kini parasysh kur planifikoni aktivitetet e tilla, pasi nevojitet të gjeni hapësirën e mjaftueshme për numrin e personave që marrin pjesë.

POZICIONIMI:

Të gjithë formojnë një rreth. Ai që e ndjen veten gati qëndron në mes të rrethit dhe tregon identitetin që ai/ajo ka zgjedhur. Kushdo që i përket atij identiteti, lëviz në mesin e rrethit. Nëse bëhet shumë personale mund edhe të mos tregojë të vërtetën.

Hidhni një vështrim përreth... Kush po qëndron ku? Si ndjehem unë në pozicionin tim?

Personi që jep kartat:

-A dëshiron të thuash diçka? Pse po qëndron atje?

-Cili kuptim bën pjesë në identitetin tuaj? A dëshirojnë të tjerë të komentoje pozicionin e tyre?

-Personi tjetër mund të drejtohet për në qendër të rrethit me identitetin e tij.

DISKUTIM PËRMBLEDHËS:

-Si ishte ky ushtrim për ju?

-Ishte e thjeshtë të mendoje dhe vendosje për 5 grupet?

-Si ishte ndërrimi në grupet e vogla? A doni të thoni ndonjë gjë rreth kësaj?

-A kishte diçka që ju habiti? (Ngjashmëria, ndryshimet, diçka të cilët nuk e prisnit?)

-Si u ndjetë gjatë pozicionimit? Si ishte ta shfaqje identitetin në grup?

-Si u ndjetë kur ishit në mes/jashtë me të tjerët? Si u ndjetë kur ishit vetëm?

-Në cilën mënyrë molekula juaj primare duhet të ndryshonte me kohën?

-Në jetën e përditshme a zgjidhni gjithmonë vetë, se cilat molekula mund të luajnë një rol të rëndësishëm?

-A zgjodhët një molekulë që ishte "kryesore" apo që do ta veçonit nga të tjerat?

-A e zgjodhët përkatësinë e kësaj molekule vetë apo e zgjodhët atë të influencuar nga të tjerët? A ndikon kjo gjë në mënyrën se si ndiheni kur i përkisni këtij grupi?

-Cilat kategori u prezantuan në molekula? Cilat nuk u prezantuan? Pse? (aspektet minoritare janë më të forta dhe intensive ndërsa anëtarët dominant shpesh shihen si "normal").

AKTIVITETI: NJE FILLIM I FRESKET

Tema: Të kuptojmë si i përdorim imazhet për vendime të menjëhershme dhe të zhvillojmë një qëndrim reflektiv dhe kritik në lidhje me veprimet paragjyquese të përditshme.

Materialet: Letër, stilolapsa

Koha: 30

Grupi: 10+

HYRJA:

Supozojmë që do të zhvillohet një eksperiment për ndërtimin e një shoqërie në një ishull të izoluar. Ju jeni pjesë e jurisë për të zgjedhur se kush mund të marrë pjesë.

Lutemi, si fillim zgjidhni vetë se kë mund të dërgoni. Pas 5 minutash bashkohuni në grupe të vogla dhe diskutoni. Prezantoni argumentat tuaja dhe përpikuni të merrni një vendim në grup. Për këtë proces keni në dispozicion 20 minuta kohë.

Zbatimi: (punë individuale + grupe të vogla)

DISKUTIM PËRMBLEDHËS:

Në përditshmërinë tonë, të gjithë krijojmë imazhe apo paragjykime për të tjerët. Këto paragjykime ndonjëherë bazohen në eksperiencat tona personale, por më së shumti ato bazohen në njohuri të pavërteta që ndërtohen në marrëdhënie shoqërore dhe shpërdahen nga mediat, reklamat, librat shkollor, familja, etj.

Këto përfytyrime shfaqen automatikisht në mendjen tonë pavarësisht nëse i duam apo jo.

Paragjykime të tilla në vetvete nuk mund të quhen akoma diskriminime, por kryesisht ato përmbajnë orientime të caktuara në

sjellje të cilat të çojnë drejt sjelljeve diskriminuese. Vëmendja e pjesmarrësve duhet të drejtohet në mënyrën sesi ata i përdorin këto paragjykime për të marrë vendime, jo vetëm në ushtrime por edhe në jetën reale.

Është e pamundur t'i shmangim plotësisht paragjykimet. Prandaj është e rëndësishme të zhvillojmë një ndërgjegje për një përfytyrim të caktuar, paragjykim, të aftë për të reflektuar në një sjellje që mund edhe ta ndryshojë atë. Kështu që si fillim duhet të njohim mirë paragjykimet dhe përfytyrimet për grupet e të tjerëve në mënyrë që të reagojmë në mënyra të ndryshme dhe jo të udhëhequra nga ato.

Jo i lirë nga paragjykimet por i vetëdijshëm për paragjykimet!

Një fillim i ri

Një grupi njerëzish iu jepet mundësia të provojnë një mënyrë jetese në një ishull të izoluar. Ata qëndrojnë në ishull për disa vite dhe nuk do të kenë kontakt me asnjë person tjetër. Është siguruar infrastruktura bazike (p.sh. shtëpitë, rrugët etj.). Personat marrin pjesë në mënyrë vullnetare në këtë projekt. Vetëm 8 persona janë të lejuar të marrin pjesë. Është detyra juaj të zgjidhni këta persona nga lista më poshtë.

- 1.Një nxënës shkolle, praktikant për t'u bërë rrobaqepës;
- 2.Një punonjës fabrike;
- 3.Një sekretar, 60 vjeç;
- 4.Një menaxher biznesi me aftësi të kufizuar fizike;
- 5.Një mësuese shtatzën;
- 6.Një kriminel, i cili sapo ka dalë nga burgu;

- 7.Një avokat i shëndetshëm;
- 8.Një ushtarak i rankut të lartë;
- 9.Një inxhinier i papunë;
- 10.Një emigrat i paligjshëm;
- 11.Një fermer i prodhimeve organike;
- 12.Një ish punonjës/e seksi;
- 13.Një shofer taksie, i cili ka studiuar sociologji;
- 14.Një politikan konservativ heteroseksual;
- 15.Një pronar i një restoranti me shërbim taksi;
- 16.Një psikoterapist i divorcuar;
- 17.Një artiste femër graffiti;
- 18.Një student me sëmundjen e SIDA-s;
- 19.Një doktor homoseksual.
- 20.Një muzikant zezak.

Ju lutem, mendoni dhe zgjidhni në mënyrë të pavarur.

Më pas diskutoni vendimet tuaja në grupe. Prezantoni argumentet tuaja dhe përpiquini të gjeni një përzgjedhje të përbashkët për një grup prej tetë personash.

15.Një pronar i një restoranti me shërbim taksi;

16.Një psikoterapist i divorcuar;

17.Një artiste femër graffiti;

18.Një student me sëmundjen e SIDA-s;

19.Një doktor homoseksual.

20.Një muzikant zezak.
Ju lutem, mendoni dhe zgjidhni në mënyrë të pavarur.

Më pas diskutoni vendimet tuaja në grupe. Prezantoni argumentet tuaja dhe përpiquini të gjeni një përzgjedhje të përbashkët për një grup prej tetë personash.

AKTIVITETI: WEB I FJALVE

Tema: Stereotipet, diskriminimi

Materialet: format/ tabela shënimesh, shënues, stilolapsa

Koha: 40/45

Grupi: 10+

Nëpër formate të veçantë letre shkruani nga një fjalë që lidhet me temat e trajnimit, për shembull: stereotip, paragjykim, diskriminim, kundër gjuhës së urrejtjes, përfshirje.

Rregulloni dhomën me 5 tavolina në vende të ndryshme, kryesisht nëpër qoshë. Vendosi secilin format nëpër tavolina dhe ndajini grupet në pesë grupe më të vogla. Secili grup bën një rrotullim nga 5 deri në 7 minuta në secilën tavolinë dhe shkruan fjalët kyçe të lidhura me fjalët që shohin të shkruar. Pasi kanë vizituar çdo tavolinë, ata shkojnë përsëri tek tavolina ku filluan dhe më pas do të bëjnë një saktësim të bazuar në fjalët kyçe.

AKTIVITETI: DISKUTIMI

Tema: Të reflektojmë për paragjykime personale/stereotipet negative

Materialet: fleta, stilolapsa, shkurmesa/ shënuesja për tabelat e bardha

Koha: 40/45

Grupi: 10+

OBJEKTIVAT:

- Të diskutojmë stereotipizimin, paragjykimin dhe diskriminimin.
 - Të reflektojmë se si ne krijojmë stereotipe për njeri-tjetrin.
 - Të lejojmë opinionet dhe diskutimin e hapur për besimet që ne kemi, të diskutojme kur dhe pse i kemi këto besime.
- 1.Shkruani në tabelë fjalitë që u diskutuan me titullin "Fakte të vërteta":
 - Nëse të gjithë emigrantët do të kthehen në shtetet e tyre, do të ketë punë të mjaftueshme për çdo kënd.
 - Vajzat janë më pak të mira në videojocra sesa djemtë.
 - Studimet shkencore tregojnë, që njerëzit me ngjyrë e kanë trurin më të vogël se ata të bardhë.

- 2.Pyesni pjesëmarrësit për reagimin e tyre. Pas kësaj, tregojuni atyre që këto pohime janë të gjitha të pavërteta. Nëse ata i besojnë, i pyesni përse. Pyetini nëse kanë dëgjuar ndonjëherë deklarata të tilla në jetën reale apo online.

- 3.Shpërndajuni fletë letre pjesëmarrësve dhe kërkojuni të shkruajnë fjali negative ose stereotipa rreth një grupi të veçantë njerëzish që mund t'u ketë rastisur të dëgjojnë, psh: Vendi i gruas është në

shtëpi, homoseksualizmi është një sëmundje, burrat duhet të luajnë sporte që të jenë të fortë, të gjithë anëtarët e komunitetit romë janë dembela, etj, etj.

- 4.Studentët nuk kanë nevojë t'i besojnë këto deklarata, kur ata i shkruajnë. Ato mund të jenë gjëra që ata i kanë dëgjuar ose lexuar. Ato duhet të jenë të shkruara në mënyrë anonime. Mblidhni të gjitha deklaratat.

- 5.Vendosni tre karrike në mes të klasës. Shpjegoni që vetëm tre persona që do të ulen në karrike do të diskutojnë, pjesa tjetër do të vëzhgojë. Nëse dikush do të dojë të marrë pjesë në diskutim, duhet të ngrëjë dorën dhe të zëri vendin e njërit prej tre personave në karriket e mesit.

- 6.Thuajini pjesëmarrësve që ata nuk duhet të shprehin vetëm idetë e tyre por mund të diskutojnë edhe opinionet e tjera që ata kanë dëgjuar për grupe të caktuara.

- 7.Zgjidhni tre pjesëmarrës për të filluar dhe zgjidhni një nga deklaratat për të filluar diskutimin. Ndërroni pjesëmarrësit herë pas here, pasi diskutimet do të jenë të lodhshme.

DISKUTIMI:

- A mësuan pjesëmarrësit gjëra të reja që nuk i dinin më parë?
- A ka ndryshuar dikush opinionin për çështje të caktuara në grupe të ndryshme?
- Pse mendoni se njerëzit mbartin pikëpamje negative për grupe të caktuara/raca/shtete të ndryshme?

AKTIVITETI: TË PËRBALLESH ME NGACMIMET KIBERNETIKE

Tema: Të reflektojmë në shkallën e ngacmimeve hibernetike si një problem dhe të identifikojmë zgjidhjet.

Materialet: katër fleta A4, lapsa/shënuesia.

Koha: 40/45

Grupi: 10 - 20

OBJEKTIVAT:

- Të kuptojmë format e ndryshme të ngacmimeve dhe lidhjen midis ngacmimeve online dhe offline.
- Të identifikojmë mënyrat e ndryshme për t'iu përgjigjur ngacmimeve, ngacmimeve hibernetike dhe gjuhës së urrejtjes online.
- Të rrisim ndërgjegjësimin e rëndësisë së përgjigjes.

Përgatitja: Në fletë A4 shënoni fjalët "Asgjë", "Përgjigju ngacmimit", "Raporto ngacmimin", "Diçka tjetër" dhe ngjiteni secilën në katër qoshet e dhomës. Sigurohuni që të ketë hapësirë të mjaftueshme për të lëvizur përreth.

UDHËZIME:

1. Filloni duke pyetur pjesëmarrësit se çfarë kuptojnë ata me ngacmim. Nxitini të mendojnë për mënyrat se si njerëzit mund të tallen.

2. Tregoni shenjat në secilën qoshe të dhomës. Shpjegojuni që ju do të lexoni me zë të lartë një numër skenaresh. Gjithkush duhet të zgjedhë se cila nga alternativat e mëposhtme është zgjedhja më e mirë.

Mos bëj asgjë.

Përgjigju ngacmimit (p.sh: angazhoji ata në diskutim, duke e vendosur veten në një

pozicion të tillë, etj.)

Raporto ngacmimin (p.sh: tek mësuesja, prindër apo autoritetet përkatëse)

Diçka tjetër (p.sh: angazho të tjerët në diskutim, krijo një grup "solidariteti" etj.)

3. Kërkojuni të shkojnë në qoshe, të shënojnë se cila është alternativa më e mirë për skenaret në vazhdim.

4. Lexoni me zë të lartë skenarin e parë dhe jepuni mundësi pjesëmarrësve të zgjedhin qoshen e tyre. Sapo ata të zënë pozicion, kërkojuni disa prej tyre të arsyetojnë zgjidhjet e tyre. Vazhdoni deri sa rastet e diskutuara të jenë të mjaftueshme.

DISKUTIMI:

A mësoi kush diçka të re?

A ndryshoi kush opinion mbi këto çështje?

Pse mendoni se njerëzit i ngacmojnë të tjerët?

Shënime-Skenarët

Ju keni marrë një numër emailësh abusive dhe mesazhe nga adresa apo numra që nuk i njihni. Disa kanë qënë kërcënuese: Duket sikur personi që po ju ngacmon ju njeh. Si reagoni ju?

Dikush nga shkolla juaj ka postuar disa foto tuajat online me komente të turpshme. Ju mendoni se e dini cili është. Si reagoni?

Një grup fëmijësh në klasën tuaj ka shpërndarë thashetheme të dëmshme për ju në rrjetet sociale. Shumë fëmijë tani nuk do të luajnë me ju dhe madje as do t'ju flasin. Si do të reagoni?

AKTIVITETI: LIRI PA KUFI

Tema: Liria e shprehjes, demokracia dhe pjesëmarrja, të drejtat e njeriut

Materialet: Tabelë shënuesë dhe shënues

Koha: 40/45

Grupi: 12 - 20

OBJEKTIVAT:

Të shqyrtojmë konceptin e lirisë së shprehjes.

Të kuptojmë pse liria e shprehjes është e rëndësishme për çdokënd.

Të shqyrtojmë pse liria e shprehjes ka nevojë të kufizohet në mënyrë që të mbrojë të drejtat e njeriut.

Përgatitja: Fotokopje në rastet kur sigurohen shënime në fund të këtij plani mësimor

UDHËZIME:

1.Pyesni pjesëmarrësit se çfarë do të thotë për ta “Liria e Shprehjes”. Grumbulloni ide në tabelën e shënimeve, duke e filluar diskutimin me këto pyetje:

a.A nënkupton liria e shprehjes që mund të themi çdo gjë që duam?

b.Nëse mendoni se disa shprehje të caktuara duhet të ndalohen, si mund të vendosim që ato duhet të ndalohen?

2.Mos u përpini ende të zgjidhni ndonjë çështje. Mblidhni më mirë opinione dhe shpjegoni se këto shpesh janë pyetje të diskutueshme, të cilat do të sqarohen përmes aktiviteteve.

3.Pyesni nëse dikush është ndaluar për të shprehur diçka në jetën e tyre. Si janë ndjer ata?

4.Siguroni disa informacione të shkurtra për lirinë e shprehjes.

5.Shpjegojuni pjesëmarrësve se do të punojnë në grupe me 4-5 vetë dhe do të diskutojnë një numër çështjesh mbi postimet që njerëzit kanë bërë online, postime të cilat janë të dëmshme për të tjerët. Grupi duhet të diskutojë dhe të vendos nëse duhet të hiqet ndonjë postim offline.

6.Ndani pjesëmarrësit në grupe prej 4-5 vetash. Shpërndajini secilit një kopje të rasteve të mëposhtme, jepuni 20 minuta kohë të diskutojnë çështjet. Ata duhet të përpinqen të sjellin shpjegime për vendimet e tyre në çdo çështje.

7.Trajtoni secilin rast, merrni përgjigjet nga secili grup dhe diskutoni shkurtimisht për vendimet e tyre.

DISKUTIM:

A ka ndonjë rast ku nuk arrini dot në një marrëveshje?

Cilat janë rreziqet për kufizimin e lirisë së shprehjes?

Cilat janë rreziqet kur falim shumë ndaj materialeve abuzuese?

AKTIVITETI: TË KUPTOSH GJUHËN E URREJTJES

Tema: Të reflektojmë për impaktin që gjuha e urrejtjes mund të ketë në shoqëri dhe tek viktimat.

Materialet: Fotokopje të shembujve të gjuhës së urrejtjes, letër dhe stilolapsa, tabela shënuese

Koha: 60

Grupi: 10- 25

Ndani pjesëmarrësit në grupe dhe jepini secilit grup një shembull të gjuhës së urrejtjes online.

Kërkojuni të diskutojnë rastet e tyre dhe të përgatiten për t'u përgjigjur. Kanë 15 minuta në dispozicion.

Diskutojini të gjithë shembujt bashkë me përgjigjet e tyre dhe shkruajini përgjigjet në tabelën shënuese.

Rishqyrtoni shënimet në formatet e tabelës shënuese dhe reflektoni me grupin.

OBJEKTIVAT:

Të kuptojmë forma të ndryshme të gjuhës së urrejtjes online dhe pasojat e saj tek viktimat online e në shoqëri.

Të kërkojmë përgjigje të mundshme për gjuhën e urrejtjes online.

Përgatitja:

Siguroni kopje të shembujve të gjuhës së urrejtjes.

Përgatisni dy formate nga tabela shënuese me titujt: "Pasojat për viktimat" dhe "Pasojat për shoqërinë".

UDHËZIME:

Pyesni pjesëmarrësit se çfarë kuptojnë ata me gjuhën e urrejtjes online. Pyesni nëse dikush ka parë shembuj të tillë. Çfarë mendojnë ata mbi ndjesitë që kanë viktimat? Si ndihen vetë ata?

Shpjegojuni pjesëmarrësve se do të analizojnë disa shembuj të gjuhës së urrejtjes online, duke e vendosur theksin në ndikimin e individëve dhe shoqërisë.

DISKUTIM:

Si u ndjetë për shembujt që grupi juaj analizoi?

Cilat janë pasojat më të zakonshme të gjuhës së urrejtjes të listuara nga grupet?

Cilat mjete apo metoda mund të mendoni për t'u adresuar gjuhës së urrejtjes online?

Çfarë mund të bëjmë nëse ne do të përballlemi me shembuj të tillë online?

A ka ndryshuar mendimi juaj pas praktikës së ushtrimeve?

AKTIVITETI: EMËRTIMET

Tema: Të reflektojmë për role të ndryshme dhe emërtime në jetën e përditshme

Materiallet: Copa letre të vogla për t'u ngjitur në ballë

Koha: 50

Grupi: 10+

Shpërndani pjesëmarrësit në grupe me 5-6 persona. Tek secili nga ata ngjisni një letër me një emërtim (disa sugjerime emërtimi i keni më poshtë), duke kombinuar emërtime positive, neutral dhe negative.

Pjesëmarrësve u kërkohet t'u tregojnë anëtarëve të tjerë se çfarë emërtimi kanë ata në ballë.

Secili grup duhet të përgatisë një detyrë dhe më pas do t'i trajtojnë dhe komunikojnë me anëtarët e grupit në varësi të emërtimeve që ata kanë.

Grupet kanë 20 minuta në dispozicion për të diskutuar së bashku për këtë detyrë.

Ndihmësit vëzhgojnë secilin grup, për të parë se si vazhdon procesi, si është komunikimi midis pjesëmarrësve, cilat janë ndjeshmëritë që ata kanë, etj.

SHËNIMT:

Pas diskutimit në grupe të vogla në mund t'i shpjegojmë pjesëmarrësve: Disa emërtime mund të jenë "lënduese" për disa nga pjesëmarrësit. Duhet t'u shpjegojmë pjesëmarrësve mos t'i marrin personale emërtimet e përzgjedhura (janë zgjedhje e rastësishme). Këto janë emërtime të përditshme, me të cilët disa njerëz përballen për shkak të përkatësisë së tyre.

Pas 20 minutash punë në grupe të vogla, pjesëmarrësit mund të diskutojnë dhe

ndajnë ndjeshmëritë e tyre në grupe më të mëdha.

-Si ishte kjo lojë për ju?

-Si u ndjetë me mënyrën si të tjerët ju trajtuan?

-A e morët me mend se cili ishte roli juaj dhe pse të tjerët po ju flisnin në atë mënyrë?

Mendoni për këta njerëz të cilët "jetojnë" me këto emërtime në jetën e tyre të përditshme.

DISA USHTRIME SUGJERIMI PËR GRUPET:

-Përgatisni një trajnim për gjuhën e urrejtjes.

-Përgatisni një work-camp me një temë të tillë.

-Përgatisni një festival kundër racizmit.

-Përgatisni një Librari Njerëzore për diversitetin.

-Përgatisni një fushatë ndërgjegjësimi në komunitet kundër diskriminimit.

Sugjerime për emërtimet

-Gra rome;

-Person me aftësi fizike të kufizuara;

-LGBT;

-Budalla;

-Llafazan;

-I Këndshëm;

-I zgjuar;

-I paaftë mendërisht;

-I trashë

-Idiot

AKTIVITETI: BËJ NJË HAP PËRPARA

Tema: Diskriminimi dhe Intoleranca – Varfëria- Të drejtat e njeriut

Materialet: kartat e roleve, një ambient me hapësirë (nje koridor, dhomë e madhe ose ambient jashtë), CD player me muzikë të qetë dhe relaksuese

Koha: 60

Grupi: 10 - 30

OBJEKTIVAT:

Të rrisim ndërgjegjësimin për mundësinë e pabarazisë.

Të zhvillojmë imagjinatën dhe mendimin kritikë.

Të nxisim ndjeshmërinë tek të tjerët që janë me më pak fat.

Përgatitja:

Lexoni udhëzimet me kujdes. Rishikoni listën e “situatave dhe ngjarjeve” dhe përshtateni me grupin me të cilin po punoni. Krijoni nga një kart rolesh për secilin pjesmarrës. Kopjoni apo përshtasni fletat në fotokopje ose me dore; i prisni në shirita i mblidhni dhe i vendosni në një kapele.

UDHËZIME:

1.Krijoni një atmosferë me muzikë të qetë në sfond. Kërkojini pjesmarrësve të mbajnë qetësi.

2.I ftoni pjesëmarrësit të tërheqin një kartë rolesh nga kapela. Shpjegojini që t'a mbajnë për vete kartën dhe mos tua tregojnë të tjerëve.

3.I ftoni që të ulen (nëse preferojnë në dyshe) dhe të lexojnë me vëmendje se çfarë është shkruar në kartën e tyre.

4.Tani kërkojuni të futen në role. Për t'iu ardhur në ndihmë lexoni disa nga pyetjet e mëposhtme duke bërë një pauz pas çdo fjalie për t'iu dhënë kohë pjesmarrësve të reflektojnë duke krijuar një imazh për veten e tyre dhe jetën e tyre.

Si ka qënë fëmijëria juaj? Në çfarë lloji shtëpie keni jetuar? Çfarë lojërash keni luajtur? Çfarë pune bënin prindërit tuaj?

Si është jeta juaj e përditshme tani? Cilat janë ambientet e jetës suaj sociale? Çfarë bëni ju në mëngjes, pasdite, në mbrëmje?

Çfarë stili jetese keni? Ku jetoni? Sa para fitoni në muaj? Çfarë bëni në kohën tuaj të lirë? Ku i kaloni pushimet?

Çfarë ju emocionon dhe nga çfarë keni frikë?

5.Tani kërkojuni pjesmarrësve të qëndrojnë plotësisht në qetësi ndërkohë që rreshtohen pranë njëri tjetrit (si në një rresht garash)

6.Tregojuni pjesmarrësve që do t'ju lexoni me zë të lartë një list me situatë dhe ngjarje. Sa herë që ata iu përgjigjen fjalive me “po” , duhet të bëjnë një hap përpara. Në të kundërt ata duhet të thonë se ku ndodhen por nuk duhet të lëvizin.

7.Lexojini situatat njëra pas tjetrës. Bëni një pauz të shkurtër midis fjalive për t'iu dhënë kohë pjesmarrësve të lëvizin përpara dhe për të parë përreth, duke marrë parrasysh pozicionet e tyre relative me njëri tjetrin.

8.Në fund ftojini të gjithë të marin parasysht qëndrimet e tyre të fundit. Më pas jepuni pak minuta kohë të dalin nga roli para përmbledhjes në takimin e fundit.

PËRMBLEDHJA DHE VLERËSIMI:

Filloni të pyesni pjesmarrësit se çfarë ndodhi dhe si u ndjenë gjatë aktivitetit dhe më pas vazhdoni të diskutoni për çështjet që u ngritën dhe se çfarë mësuani.

Si u ndjen pjesmarrësit kur hidhnin një hap përpara ose jo?

Për ata që bënë shpesh hapa përpara në cilin moment e vunë re që të tjerët nuk po lëviznin aq shpejt sa ata?

A pati njeri ndjesinë që kishte momente kur të drejtat njerëzore bazike po injoroheshin?

A mund ta marrin me mend pjesmarrësit rolin e njëri tjetrit? (Lejoni pjesmarrësit të zbulojnë rolet e tyre gjatë kësaj pjese diskutimi)

Sa e lehtë apo e vështirë ishte të juaje role të ndryshme? Si e imagjinuan ata personin me të cilën luajtën?

A u pasqyrua shoqëria tek ushtrimet në një farë mënyre? Si?

Cilat nga të drejtat njerëzore janë në rrezik për secilin rol? A mundet ndonjë të thotë që të drejtat e tyre njerëzore nuk u respektuan ose ata nuk kishin akses tek ato?

Cilat janë hapat e para që duhen marrë për t'iu adresuar pabarazisë në shoqëri?

KARTAT E ROLEVE:

Ju jeni një nënë beqare e papunë.

Ju jeni presidenti i një organizate rinore e një partie politike (parti "nëna" e cila është tani në pushtet).

Ju jeni bija e një menaxheri të një banke

lokale.

Ju studioni ekonomi në universitet.

Ju jeni djali i një emigranti kinez që drejton një biznes të suksesshëm me fast-food.

Ju jeni një vajzë muslimane arabe që jetonë me prindërit e vet të cilët janë të devotshëm pas fesë.

Ju jeni bija e ambasadorit amerikan në vendin ku banoni tani.

Ju jeni një ushtar në ushtri, duke bërë shërbimin e detyruar ushtarak.

Ju jeni pronar i një kompanie të suksesshme import- eksporti.

Ju jeni një i ri me aftësi të kufizuara i cili lëviz vetëm në karrige me rrota.

Ju jeni një pensionist ku keni punuar si punëtor në një fabrikë këpucësh.

Ju jeni një 17-vjeçare Rome (Gypsy) që nuk e ka përfunduar shkollën fillore.

Ju jeni e dashura e një artisti të ri i cili ka krijuar varësi nga heroina.

Ju jeni një prostitutë në moshë mesatare më sëmundjen e SIDA-s.

Ju jeni një 22-vjeçare lezbike.

Ju jeni një i sapodiplomuar duke pritur mundësinë e parë për të punuar.

Ju jeni një modele me origjinë afrikane.

Ju jeni një refugjat 24-vjeçar nga Afganistani.

Ju jeni një i ri pastrehë, 27 vjeç.

Ju jeni një emigrant i paligjshëm nga Mali.

Ju jeni një 19-vjeçar, djali i një fermeri.

SITUATAT DHE NGJARJET:

Lexoni situatat e mëposhtme me zë të lartë. Pasi të lexoni situatat jepuni kohë pjesmarrësve për çdo situatë të bëjnë një hap përpara dhe gjithashtu të shikojnë sa përpara kanë ecur ata krahasuar me të tjerët.

Ju nuk keni hasur kurrë në ndonjë vështirësi financiare serioze.

Ju keni një shtëpi modeste me një telefon dhe televizion.

Ju e ndjeni respektin ndaj gjuhës, fesë dhe kulturës në shoqërinë ku jetoni.

Ju e ndjeni se mendimi juaj për çështjet sociale dhe politike kanë rëndësi dhe pikëpamjet tuaja dëgohen.

Njerëz të tjerë konsultohen me ju për çështje të ndryshme.

Ju nuk jeni frikë nëse ndaloheni nga policia.

Ju e dini se ku të drejtoheni për këshilla dhe ndihmë, nëse keni nevojë.

Ju nuk jeni ndjer kurrë i diskriminuar për shkak të prejardhjes tuaj.

Ju keni mbrojtjen e duhur sociale dhe mjekësore për nevojat tuaja.

Ju mund të shkoni me pushime një herë në vit.

Ju mund t'i ftoni miqtë për darkë në shtëpi.

Ju keni një jetë interesante dhe jeni pozitiv për të ardhmen tuaj.

Ju e ndjeni që mund të studioni dhe të keni profesionin që dëshironi.

Ju nuk keni frikë nga ngacmimet apo sulmet në rrugë apo nga mediat.

Ju mund të votoni në zgjedhjet kombëtare dhe lokale.

Ju mund të festoni festat më të rëndësishme fetare me të afërmit dhe miqtë tuaj të ngushtë.

Ju mund të merrni pjesë në një seminar ndërkombëtar jashtë vendit.

Ju mund të shkoni në kinema apo teatër të paktën një herë në javë.

Ju nuk keni frikë për të ardhmen e fëmijëve tuaj.

Ju mund të blini rroba të reja të paktën një herë në tre muaj.

Ju mund të bini në dashuri me personin që doni.

Ju e ndjeni se kompetenca juaj vlerësohet dhe respektohet në shoqërinë ku jetoni.

Ju mund të përdorni benefite nga interneti.

Ju nuk keni frikë nga pasojat e ndryshimeve klimatike.

Ju jeni të lirë të përdorin çdo faqe në internet pa frikën e çensurës.

Shembuj për këto lloj aktivitete mund t'i gjeni online, falas në Kompas, Manual për të Drejtat e Njeriut Edukimi me të rinjtë, përgatitur nga Këshilli Europian. Shkarkoni falas nga: <https://www.coe.int/compass>

AKTIVITETI: LULJA E PUSHTETIT

Tema: Marrëdhëniet e pushtetit në shoqëri dhe pozicioni im në të.

Materialet: lule të printuara, (ose mund t'i lini pjesmarrësit t'i krijojnë vetë), stilolapsa.

Koha: 60

Grupi: 10- 30

Pjesmarrësit ftohen që të vendosin në mënyrë të pavarur për pozicionin e tyre individual në marrëdhëniet e pushtetshme në shoqërinë ku ata jetojnë. Lidhur me këtë ata do të plotësojnë "lulen e pushtetit". Mënyrën se si do ta bëjnë është e shpjeguar në fletët e punës.

Në grupe të vogla ju kërkohet të prezantoni lulen e pushtetit të njeri tjetrit. Sigurohuni që të mbani kufirin tuaj. Tregojini atyre vetëm atë që do të donit t'iu tregonit të tjerëve.. Mund t'ë diskutoni brenda grupit ngjashmëritë, ndryshimet apo eksperiencat, të cilat lidhen me pushtetin e kategorive të ndryshme.

Zbatimi (Puna individuale punë+ grupe të vogla) shikoni tek faqet e metodës

TEMA TË MUNDSHME PËR DISKUTIM NË TAKIM:

-Proçesi i punës individuale dhe punës në grupe të vogla

-Ku ishte e vështirë të vendosje se në cilën petale duhet të shënosh? Ku ishte e lehtë? Pse?

-Eshte e rëndësishme të dish pozicionin e

vet në kushtet e dominancës, nëse diskutojmë kontekstin e presionit.

Reflektimi i pozicionit bën të mundur të theksohet dhe ndihet me të tjerët dhe të veprsh me përgjegjësi.

-Ne jemi pozicionuar të gjithë në ndërprerjet e disa rreshtave të ndryshëm, të cilat ndonjëherë janë në anën e privilegjuar dhe ndonjëherë në anën e marginalizuar.

-Nuk bëhet fjalë për të provokuar një ndërgjegje që ndihet në faj për shak të privilegjeve që kemi por nuk bëjme asnjë për t'i marrë ato, por do të donim të inkurajonim ndërgjegjësimin që ka të bëjë me privilegjet ku pozicionohemi.

-Është e rëndësishme të kujtojmë që ata në pozicione dominuese shpesh nuk e shohin pushtetin e tyre ndërsa ata që janë në pozicione të marginalizuara shpesh e ndjejnë mungesën e pushtetit shume qartë.

-Kundra – paragjykues do te thotë të kërkosh të ndërmarrësh hapa kundër këtyre strukturave.

Në vazhdimësi kemi përmendur disa kategori të rëndësishme të pushtetit, të cilat mund ta diferencojnë shoqërinë në të privilegjuar dhe jo të privilegjuar.

-Gjuha

-Ngjyra e lëkurës

-Gjinia

-Orientimi seksual

-Shëndeti

-Besimi fetar

- Aspekti social
- Situata financiare
- Aparencia
- Nënshtetësia
- Aspekti gjeografik
- Rezidenca
- Edukimi
- Situata familjare
- Moshë

1. Kategoritë: Shiko me vëmendje kategoritë në listë. Këto janë sugjerimet tona për kategoritë që kanë një ndikim në shoqëri, kanë një orëvajtje për të treguar se sa fuqi (pushtet) mund të ketë një person. Kjo lule e pushtetit është bazuar në strukturat në Gjermani. Ne po përpiqemi ta përhapim në vende të tjera. Ju mund të diskutoni nëse këto kategori janë të përshtatshme për vendin tuaj ose nëse marrëdhëniet e pushtetshme janë të strukturuar ndryshe. Mund të plotësoni ato kategori që besoni se janë të rëndësishme për shoqërinë tuaj në rrethin e brendshëm të lules.

2. Grupet e privileguara dhe jo të privileguara: petalet e brendshme

simbolizojnë grupet sociale më të privileguara, petalet e jashtme qëndrojnë për grupet më pak të privileguara. Mendoni se cili është grupi më i privileguar dhe aspak i privileguar në vendin tuaj dhe shkruani termin që përcaktojnë secilin grup. Për shembull: në Gjermani në kategorinë e edukimit të privileguarit janë ata të cilët janë diplomuar veçanërisht nga shkolla e mesme. Njerëzit e paprivileguar janë ata të cilët nuk e kanë përfunduar shkollën (ose nuk kanë marrë një certifikatë).

3. Pozicioni juaj: Ju lutem shënoni këto petale, tek të cilat mendoni se i përkisni (ndjesia e përkatësisë, anëtarësisë). Kur nuk jeni i sigurt, cila petale ju përshatet juve, vizatoni një që mendoni se përshatet më shumë. Nëse është e nevojshme, mund të vizatoni një petale të tretë, në rast se nuk i përkisni asnjë prej këtyre dy kategorive që janë listuar.



**NO HATE
SPEECH
MOVEMENT**

KAPITULLI 5: REKOMANDIME DHE KONKLUSIONE

REKOMANDIME



- Të rinjtë duhet të informohen më shumë në lidhje me stereotipat, paragjykimet dhe diskriminimin, rreth dallimeve dhe të përbashkëtave. Trajnimet në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtarë janë shumë të nevojshme për të rinjtë.
- Duhet të ketë më shumë nxitje dhe aktivizim qytetar për të reaguar ndaj rasteve diskriminuese apo kur përdoret gjuha e urrejtjes.
- Duhet më shumë aktivitete të cilat të nxisin reflektimin e të rinjve rreth situatave dhe efekteve të diskriminimit, të ngjashme me Libraritë Njerëzore, ndarjen e eksperiencave konkrete, takime mes grupeve që janë më tepër të diskriminuara. Këto japin ndikim të thellë tek të rinjtë, i bëjnë të reflektojnë dhe ndryshojnë qëndrimet e tyre në mënyrë graduale.
- Duhet të realizohen studime më të thelluara në nivel kombëtar me target-grupe të ndryshme, me një numër më të lartë të të anketuarve, duke përfshirë edhe zonat rurale. Janë të pakta apo pothuajse mungojnë të dhënat për të matur perceptimin dhe nivelin e informacionit rreth këtyre fenomeneve në zonat rurale, aty ku mentaliteti është më i mbyllur dhe grupet janë pothuajse homogjene. Studimet janë gjithashtu të nevojshme dhe në grupmosha më të mëdha pasi botëkuptimi i tyre është i ndryshëm nga i të rinjve.
- Është i nevojshëm bashkëpunimi më i gjerë ndërmjet të rinjve, grupeve të diskriminuara, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare në nivel lokal dhe vendor. Një bashkëpunim i ndërsjellët mund të sjellë rezultate shumë domethënëse në parandalimin e rasteve të diskriminimit, raportimin dhe luftën ndaj tyre.
- Është e rëndësishme të ketë më shumë aktivitete në lidhje me diversitetin dhe tolerancën, në shkollat fillore dhe ato të mesme. Metodatat e edukimit jo formal duhet të promovohen dhe përdoren më së shumti në aktivitete me fëmijët dhe të rinjtë. Duke edukuar, rritur nivelin e informacionit që në moshë të hershme, do të kemi një përmirësim të dukshëm të situatës.

- Është e rëndësishme të promovohen më gjerë shembujt pozitiv, sfidat dhe arritjet e personave që vijnë nga komunitete më shumë të diskriminuara. Duke parë shembuj konkret të arritjeve të kategorive të ndryshme, të rinjtë do të reflektojnë më shumë dhe do të kuptojnë se Romët nuk janë dembel, se një grua apo vajzë në karrierë jo domosdoshmërisht duhet të jetë e bukur apo të përdor favore të tjera për të qenë e suksesshme, se personat me aftësi të kufizuara mund të martohen dhe të jetojnë normalisht ashtu si çdo kush tjetër.
- Media duhet të luaj një rol më aktiv në reduktimin e stereotipave, paragjykimeve dhe diskriminimit.
- Të rinjtë duhet të nxitin dhe angazhohen më tepër në aktivitete vullnetare në Shqipëri dhe jashtë saj, duhet të informohen dhe të përdorin mundësitë që ofrohen nga shumë programe evropiane si trajnime të Këshillit të Evropës, projekte nga Erasmus+ Program, shkëmbimet ndërmjet universiteteve, kampet verore, mundësitë e vullnetarizmit afatgjatë, etj. Gjithashtu, edhe PVN duhet të punoj më shumë në informimin dhe angazhimin e të rinjve në aktivitete shkëmbyese në Shqipëri dhe jashtë saj, duke qenë se ka një sërë partnerësh në shumë vende të botës, me të cilët të rinjtë mund të angazhohen.
- Duhet të ketë informacion më të zgjeruar rreth mekanizmave se ku raportohen rastet e diskriminimit dhe cilat janë procedurat që duhet të ndjek një qytetar përkatësisht në secilin institucion.
- Informim mbi kuadrin ligjor dhe respektim më i fortë i tij.

KONKLUZIONE

-Të rinjtë kanë mungesë informacioni në lidhje me stereotipat, paragjykimet, diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes. Ata e kanë të vështirë të bëjnë dallimet mes termave.

-Vihet re indiferentizëm apo mosreagim nga ana e të rinjve nëse do të identifikonin raste konkrete të diskriminimit.

-Të rinjtë nuk kanë informacion se ku dhe si duhet të raportojnë rastet e diskriminimit nëse përballen me të apo janë dëshmitar të tij.

-Rreth 50% e të rinjve të intervistuar janë ndjerë të diskriminuar si dhe kanë diskriminuar grupet apo individët e tjerë.

-Shkollat dhe universitetet perceptohen si institucionet që kanë rol parësor në

reduktimin e diskriminimit.

-Komuniteti LGBT rezulton komuniteti më shumë i diskriminuar në Shqipëri.

-Janë të pakta idetë apo nismat konkrete që të rinjtë mund të ndërmarrin për të luftuar stereotipat, paragjykimin, diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes.

-Takime me individ nga komunitete që ndeshin diskriminim më së shumti, si LGBT, Personat me Aftësi të Kufizuara, Romë dhe Egjiptian japin ndikim më të madh në reflektimin dhe ndryshimin e qëndrimeve të të rinjve.

-Rreth gjysma e të rinjve të përfshirë në këtë kërkim mendojnë se, trajnimet janë mënyra më e mirë për të reduktuar stereotipat, paragjykimet, diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes.

ACKNOWLEDGEMENTS

BIBLIOGRAPHY

- Brander,P De Witte,L, Ghanea,N, Gomes,R, Keen,E, Nikitina,A, Pinkevičute,J. (2012). Background Information on Global Human Rights Themes. In: Brander,P, Keen,E, Juhász,V, Schneider,
- A Compass Manual for human rights education with young people. 2nd ed. Hungary: Council of Europe Publishing. p474-486.
- Social Biases: Prejudice, Stereotyping, and Discrimination/Keene | 3 www.jghcs.info [ISSN 2161-0231 (Online)] JOURNAL OF LAW ENFORCEMENT/VOLUME 1, NUMBER 3
- Gabriel,Y. (2012). The Other and Othering. Last accessed 12th Jan 2017.

PHOTOS FROM TRAINING IN TIRANA



